

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7559 E enjte 14 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Ekskluzive në "GSH"

Kosova e Re, shtet i lirë e i pavarur; por me sovranitet ende të gjymtuar, ka mjaft risi. Njëra prej këtyre risive të Kosovës së Re janë edhe milionerët e saj...
Vijon në faqen 20

Nga REXHEP QOSJA

Milionerët politikë dhe të varfrit



Opinion i Ditës

Nga ARMAND PLAKA

Historia e Shqipërisë e sidomos stacionet e saj të vona kanë bërë që të përjetojmë gjatë këtyre dekadave të pluralizmit shumë zënka e debate. Thuajse ...
Vijon në faqen 21

Brezi i ri i historianëve dhe nevoja për rikonceptimin e gazetarisë historike!



Aktori i njohur: S' mund tëk trokas te Aneta

Prishja e Teatrit, Robert Ndrenika: Të nisë lufta. Meta, apel Ramës: Dëgjoji

Fundi i llogaridhënies publike, PS-ja braktis komisionin ku po flisnin artistët

FATMIRA NIKOLLII

Ndonëse qeveria ka nisur takimet e llogaridhënies publike nëpër rrethe, për të marrë ankesat e qytetarëve, prej katër muajsh, edhe pse në kryeqytet, aktorët që kërkojnë të mbrojnë Teatrin Kombëtar, as nuk i pret e as ...
Në faqen 18-19

LISTA/ SA PARA PERFITONJE PRONARET QE IU ZU TOKA NGA "INFORMALET"

NDERTIMET PA LEJE, 2 MIJE EMRAT QE KOMPENSOHEN

Agjencia e Trajtitimit të Pronës publikon përfituesit e fondit të ALUIZNI-t dhe procedurën për të marrë paratë. 6 dokumentet që duhen dorëzuar



(Në foto) Zonë informale

Në faqen 12-15

TE ARDHURIT NGA SIRIA



Rama: S'kemi kërkesë për kamp refugjatësh. Kancelari austriak: Do ta shqyrtojmë
Në faqen 5

Masakrimi i Anxhela Meçanit në Itali, apeli i familjes: Nuk kam para të sjell trupin

I ati i 20-vjeçares: Si e mësova vdekjen e vajzës

Dritan Meçani: Para 5 muajsh i vdiq e ëma, nuk erdhi se nuk kishte dokumente

Nga ERVIS KUÇI

FIER-Vrasja makabre e 20-vjeçares Anxhela Meçani ka tronditur familjarët e saj. Pak ditë pas ngjarjes së ndodhur në Torino të Italisë, ku e reja e dhunua barbarisht deri në vdekje dhe më pas u hodh nga



makina, ka reaguar babai i viktimës, Dritan Meçani nga Gjirokastra. Mes dhimbjes së madhe, ai ka kërkuar drejtësi dhe zbardhjen sa më shpejt të ngjarjes. "Gazeta Shqiptare" kontaktoi me të atin e 20-vjeçares në fshatin Baltëz të Fierit ...
Në faqen 9

"BENI VETINGUN"

Njeriu i Merkel në Tiranë: Tahiri dhe Xhafaj s'janë kusht për integrimin
Në faqen 2

NGA FERDINAND SAMARXHI

Muaji i Ramazanit, sakrificë, solidaritet, detajet e programit mbarëkombëtar
Në faqen 16-17

KUFIJTE DETARE

Pakti i ri detar Shqipëri-Greqi, Rama i shkollon Metës në zyrë
Në faqen 4

SHENDETESI

Mjeku Ylli Merja: Receta si kurohen me çaj bimor infeksionet e syve
Në faqen 10

NEGOCIATAT KUSHTET

Valentina Madani

Gjermania ende nuk ka një vendimarrje për votë pro apo kundër hapjes së negociatave për Shqipërinë në fund të qershorit. Klasës politike i kërkon konsensus për thellimin e reformave dhe shmangien e konflikteve. I dërguari i Kancelares gjermane në Tiranë, Sekretari i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin në Ministrinë Federale të Drejtësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Christian Lange, bëri të qartë dje në Tiranë se për hapjen e negociatave reforma në drejtësi do jetë kyçe në këtë vendimarrje. "Sot ende nuk mund t'ju jap një përgjigje lidhur me vendimin që do marrë qeveria federale në këtë drejtim. Por ajo që mund t'ju them është se progresi në reformën e drejtësisë, përsheptimi i reformave në procesin e drejtësisë është një nga hapat e rëndësishme që do të kenë ndikim në këtë vendimarrje dhe sic jeni të informuar ky është një vendim unanimit që merret nga shefat e qeverive dhe të shteteve. Patjetër që edhe shtete të tjera anëtare do të hedhin veshtrimin nga sistemi i drejtësisë të Shqipërisë. Sistemi i drejtësisë është i rëndësishëm edhe për ne, ka një rëndësi të madhe, kjo është arsyeja që unë kam ardhur sot", tha z. Christian Lange. Kur na ndajmë vetëm 2 javë nga vendimi për hapjen e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, zyrtari gjerman bëri të ditur se Gjermania do të ketë vendimin e saj brenda afateve kohore. "Ne do ta marrim vendimin tonë në kohë, vendim që do merret para mbledhjes së Këshillit Europian. Çështja e zhvillimeve në fushën e drejtësisë do të luajë një rol të rëndësishëm. Sistemi i drejtësisë është çelësi për një zhvillim ekonomik. Një shtet i së drejtës që funksionon është dhe baza për funksionimin e ekonomisë dhe biznesit", deklaroi z. Lange.

Gjermania pa datë për negociatat, i dërguari i Merkel: Luftoni korrupsionin

Negociatat, Lang: Konsensus mes palëve, të shmangen konfliktet

Kusht përsheptimi i vetingut, jo "Tahiri" e "Xhafaj"



Sekretari i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin në Ministrinë Federale të Drejtësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Christian Lange

VENDIMARRJA
"Ne do ta marrim vendimin tonë në kohë, vendim që do merret para mbledhjes së Këshillit Europian. Çështja e zhvillimeve në fushën e drejtësisë do të luajë një rol të rëndësishëm. Sistemi i drejtësisë është çelësi për një zhvillim ekonomik. Një shtet i së drejtës që funksionon është dhe baza për funksionimin e ekonomisë dhe biznesit", deklaroi z. Lange.



Parlamenti Europian

BLLOKIMI

"Bllokadat politike nuk ndihmojnë për të ecur përpara me reformat në vendin tuaj. Ne gjermanët jemi të prirur për konsensus, gjë që të ju s'e kam parë. Konsensusi është diçka që ndihmon shtetin e së drejtës dhe forcimin e demokracisë. Procesi i vetingut është duke u zbatuar, është mirë të zbatohet më shpejt. Përsheptimi i reformës në drejtësi është hap i rëndësishëm që do ndikojë në këtë vendimarrje", - tha Lange.

Votë tjetër kundër Amerikës?

Denoncimi te Berisha: Shqipëria ka votuar për Marokun dhe kundër SHBA

Një qytetar dixhital i shkruan ish-kryeministrit Sali Berisha për të denoncuar atë që e quan një tjetër votë të Shqipërisë kundër SHBA. Sipas denoncuesit, Shqipëria ka votuar për Marokun dhe kundër SHBA, Kanada e Meksikës për zhvillimin e kampionatit të ardhshëm të futbollit! "Një akt tjetër i shëmtuar anti-amerikan i Noriegës! Shqipëria me urdhër të Edvinut voton për Marokun dhe kundër SHBA, Kanada e Meksikës për zhvillimin e kampionatit të ardhshëm të futbollit! Sb "Doktor, shihe si Shqipëria tradhdoi Amerikën edhe në FIFA", -thuhet në me-



sazhin dërguar z.Berisha. Po dje ish-kryeministri Sali Berisha ka publikuar në faqen e tij të "Facebook" një mesazh nga qytetari dixhital ku ky i fundit denoncon një ngjarje që ka ndodhur në

20 maj në Rinas. Sipas Berishës, në këtë datë në Rinas janë zbuluar 120 kg fare kanabisi në thasë, ndërsa theksojnë se skandal i është mbajtur i fshehtë nga Rama dhe ministri Xhafaj. Denoncuesi, një oficer policie, tha se farat e kanabisit janë gjetur në disa pako të ardhura nga linja Holandë-Francë-Shqipëri. "Rama i drogës dhe Geroni i tij fshehin superskandalin! Me dt. 18 maj kontrolli në Rinas zbulon 120 kg fare kanabisi në thasë. Me urdhër direkt të Ramës fshehet ky krim, ndërkohe thasët me farën e drogës janë zhdukur", -shprehet ish-kryeministri Berisha.

brendshme prandaj edhe kjo gjë më ka surprizuar. Nuk është praktikë e zakonshme e Gjermanisë të mbajë qëndrime për politikat e brendshme të shteteve", deklaroi z. Lange. Të njëjtin qëndrim ai ndau dhe kur u pyet nëse çështja Tahiri është kusht i Gjermanisë për negociatat. "Nuk është e za-

konshme që raste të veçanta të kthehen kusht për projekte europiane, më shumë nuk kam çfarë t'ju them", -tha ai. Shqetësim për të Shqipëri vijon të mbetet korrupsioni. Si dëshmi të këtij fenomeni solli shqetësimin e disa investitorëve të vendit të tij që operojnë në Shqipëri. "Investitorët gjermanë në

sollën në vëmendje se problemi kryesor që kanë është korrupsioni. Korrupsioni mbështet krimin e organizuar, terrorizmin dhe është risk për aparatit e sigurisë. Korrupsioni në sistemin e drejtësisë pengon qasjen në gjyqësor, që është baza për sistemin e drejtësisë dhe për një proces të ndershëm", -

theksoi z.Lange. Zyrtari i lartë gjerman kërkoi që politika shqiptare të vijojë thellimin e reformave dhe të shmangë konfliktet. "Bllokadat politike nuk ndihmojnë për të ecur përpara me reformat në vendin tuaj. Ne gjermanët jemi të prirur për konsensus, gjë që të ju s'e kam parë. Konsensusi është diçka



Saliqani, në familjet e dy protestuesve kuksianë: Në burg duhet të jetë Rama

Sekretari i aksionit politik në PD, Ervin Saliqani, vizitoi dje familjet e dy prej kuksianëve të protestës në Rrugën e Kombit, të cilët mbahen ende në burg. Vasil Laçi dhe Isuf Gashi. Situata e tyre është shumë e vështirë, dhe burgosja e familjarëve të tyre u ka shtuar më shumë varfërinë dhe borxhet në familjet e tyre në Kukës. Babai i Isuf Gashit tregon se për çdo vizitë në Tiranë tek djali në burg merr 100 mijë lekë borxh. Familja e Vasil Laçit ka dy fëmijë. Askush nuk është në punë dhe ata jetojnë në ndihma nga të afërmit në një shtëpi që ka vetëm 4 muret. Saliqani tha se: "Në burg sot për shkak se shkel ligin duhet të jetë Edi Rama dhe ata që bëjnë miliona euro në kurriz të më të varfërve të vendit. Ne jemi këtu për t'ju thënë që jo vetëm nuk do t'ju harrojmë dhe do të japim ndihmë deri në fund, sepse janë heronj për Shqipërinë dhe kanë vendosur një gur të rëndësishëm me atë akt që kanë bërë. Ai tregon se zotër janë shqiptarët, qytetarët dhe, pavarësisht se janë të varfër e nuk kanë mundësi për jetesën, prapë reagojnë dhe tregojnë se ky vend për zot ka shqiptarët. Nuk është pronar as Edi Rama, as këta të koncesionarit".

që ndihmon shtetin e së drejtës dhe forcimin e demokracisë. Procesi i vetingut është duke u zbatuar, është mirë të zbatohet më shpejt. Ajo që mund t'ju them është se përsheptimi i reformës në drejtësi është hap i rëndësishëm që do ndikojë në këtë vendimarrje", -u shpreh Christian Lange.



Ambasadorja e BE: Pa finalizimin e reformës, Shqipërisë do t'i duhet të presë edhe shumë vite

Kushtet për negociatat, Vlahutin: Reforma në drejtësi nuk ka kthim pas

"Jemi të duruar për të parë ndryshimet"

Valentina Madani

Bashkimi Evropian do të mbështesë zbatimin e planit të reformës në drejtësi në Shqipëri. Ambasadorja e delegacionit të BE-së në Tiranë Romana Vlahutin deklaroi dje se reforma në drejtësi nuk do të ketë kthim pas. Në Pallatin e Kongreseve u prezantua dje nisja e projektit EURALIUS V, që synon konsolidimin e sistemit shqiptar të drejtësisë. Të pranishëm ishin ambasadorja Romana Vlahutin, Ministria e Drejtësisë Etilda Gjonaj dhe Christian Lange nga Ministria Federale Gjermane e Drejtësisë. Diplomataja e misionit të BE në Tiranë, Vlahutin është shprehur se pas reformës në drejtësi pritet një ndryshim themelor, nga lufta kundër korrupsionit të zbatimi i të drejtave të njeriut. Në nisjen e sesionit të pestë të EURALIUS, u nënvizua mbi të gjitha lufta ndaj korrupsionit. "Me asistencën e EURALIUS, BE do të japë një ekspertizë mjaft të mirë për të drejtat e njeriut, por edhe luftën kundër korrupsionit në vend për të bërë Shqipërinë një vend me të drejta të barabarta për të gjithë. Reforma në Drejtësi është një instrument i mirë për sigurinë dhe le të besojmë që ndryshimi është i mundur, duhet durim. Nuk ka kthim pas, sistemi i drejtësisë është një realitet dhe ne jemi të duruar për të pritur ndryshimin për të ardhmen", u shpreh Romana Vlahutin.



Ambasadorja e delegacionit të BE-së në Tiranë, Romana Vlahutin

REFORMA
"Reforma në Drejtësi është një instrument i mirë për sigurinë dhe le të besojmë që ndryshimi është i mundur, duhet durim. Nuk ka kthim pas, sistemi i drejtësisë është një realitet dhe ne jemi të duruar për të pritur ndryshimin për të ardhmen", - u shpreh Romana Vlahutin

"Shumë shpejt përfundojmë negociatat"

Kotzias: Nuk iki me pushime pa zgjidhur problemet me Shqipërinë

Vetëm një ditë pasi zgjidhën me Shkupin mosmar rëveshjen 27-vjeçare për emrin, Greqia duket e vendosur për t'u dhënë zgjidhje edhe çështjeve të mbartura me Shqipërinë. Ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias, ishte i prerë kur tha se nuk ikën në pushime pa i zgjidhur këto çështje. "Se shpejt zgjidhim problemet me Shqipërinë. Ndodhemi në procesin e zgjidhjes së problemeve që rezultojnë që prej 70 vjetësh. Nuk shkoj me pushime pa i zgjidhur", deklaroi ministri i Jashtëm grek. Deklaratat Kotzias i bëri pas takimit me homologun e tij rus Sergei Lavrov në Moskë. Ministri i Jashtëm i Greqisë, Nikos Kotzias foli për Shqipërinë gjatë një ligjërate që mbajti në Universitetin MGIMO të Moskës. "Me politikë aktive po zgjidhim me Shqipërinë probleme dekadash. Besoj se shumë shpejt përfundojmë negociatat me Shqipërinë", deklaroi ministri i Jashtëm grek. Kotzias tha, gjithashtu, se paketa prej dhjetë çështjesh përfshin edhe përcaktimin e kufijve dhe të zonave detare.

Protesta, FRPD: Me Xhafajn e Tahirin s'ka Europë

Të rinjtë e FRPD dhe LRI gjatë protestës dje para Ministrisë së Brendshme ironizuan llogaridhënien publike të kryeministrit Rama në takimet me qytetarët në gjithë vendin, duke e cilësuar si "Llogaridhënie publike e Narkoshtetit". Ata inskenuan një takim të tillë me maska, duke zhvilluar një dialog ironizues me fytyrat e kryeministrit, ministrave, kryetarëve të bashkive dhe krerëve të grupeve të narkotrafikut. "Te rinjtë në '90 rrezuan diktaturën komuniste, sot është koha jonë të rrezojmë diktaturën e kirit dhe drogës. Me Fatmir Xhafajn e Sajmir Tahirin s'ka Europë. Përgjegjës për këtë është vetëm Edi Rama. Ndaj dhe sot kemi vendosur ta dëbojmë përfundimisht Edi Ramën nga Shqipëria", deklaruan të rinjtë e FRPD.

Permbartuesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shtinë ne ankand pasurine :

"Toko Are me sip 865 m2 , me Nr pasurie 131786 Zona kadastrale nr 1896 , Volumi 9 , faqe 44 , me vendndodhje Grude e re Shkoder .
2. Cmmi me të cilin do të fillojë shtija në Ankand për pasurinë e sferpershkruar , është në vlerën 336.000 (Treqind e tridjetë e gjashtë mijë) Lekë .

Shtija e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me date 18.06.2018 ora 16.15 në Zyren e përmbartuesit gjyqësor Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko Perbalje Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051,

Mesazhi i ministres për "armiqtë" e drejtësisë

Gjonaj: Të përshpejtohet vetingu për institucionet e reja të drejtësisë

Ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, kërkoi dje përshpejtim të procesit të vetingut për të krijuar sa më shpejt institucionet e reja të drejtësisë. Ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, kishte një mesazh për ata që i quajti armiqtë e reformës në drejtësi. Ajo tha se vetëm me ngritjen e KLGJ dhe KLP do të futet në rrjedhën e duhur miradmirimit i drejtësisë dhe sistemit gjyqësor. "Pa mbështetjen sa politike po aq dhe teknike të ambasadorëve të BE, ShBA, Gjermanisë, Austrisë, Holandës etj. dizenjimi dhe miratimi i reformës në drejtësi do të ishte tepër i vështirë. Kemi përfunduar një pjesë të mirë të rrugëtimit. Tashmë ndodhemi para sfidave të reja për zbatimin e kësaj reforme. Përpjekjet e shkaktuara nga kundërshtarët e reformës do të mbeten vetëm përpjekje të dështuara dhe vështirësitë e hasura nuk duhet të na frikësojnë", deklaroi znj. Gjonaj. Sipas saj "Procesi i rivlerësimit kalimtar ka prodhuar rezultatet e para të ndeshme për vetë sistemin dhe qytetarët shqiptarë. Shumë shpejt pritet të përfundojë rivlerësimi i listës prioritare së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ritmi i procesit të vetingut duhet të përshpejtohet nga institucionet e përfshira në këtë proces për të bërë të mundur ngritjen e institucioneve të reja të drejtësisë sa më parë". Me ngritjen e KLGJ



SFIDA

"Tashmë ndodhemi para sfidave të reja për zbatimin e kësaj reforme. Përpjekjet e shkaktuara nga kundërshtarët e reformës do të mbeten vetëm përpjekje të dështuara dhe vështirësitë e hasura nuk duhet të na frikësojnë", tha ministria Gjonaj.

lejojë vetes t'i humbasë", tha znj. Vlahutin. Për më tepër, shtoi ajo duke bërë një reformë kaq të vështirë dhe të guximshme, Shqipëria ka afruar shumicën e përmbajtjes së kapitujve 23 dhe 24 dhe ka kursyer kohë në të ardhmen. Kjo sipas saj është një ndërmarrje e paprecedent dhe e ka veçuar Shqipërinë si një model për shumë vende. "Ndryshimi kërkon kohë, kërkon durim,

por ka, gjithashtu, edhe disa pengesa. Por ajo çka është e rëndësishme është se nuk ka kthim prapa. Sistemi i ri gjyqësor në Shqipëri tani është një realitet kushtetues dhe ka shtruar rrugën që Shqipëria të ndryshojë dhe të përparojë, si dhe që gjeneratat e reja të avokatëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve të sjellin cilësi të re në sistem", deklaroi Vlahutin. Të pranishëm në ceremoninë

e djeshme ishin personalitetet të larta të organeve ligjzbatuese, kryeprokurorja e Përgjithshme Arta Marku, gjykatës, prokurorë si dhe ekspertë që kanë punuar për hartimin e reformës në drejtësi. Misioni EURALIUS V, më përfaqësues nga disa vende të Bashkimit Evropian do të asistojnë organet e reja të sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

SITUATA POLITIKE REAGIMET

Kreu i Kuvendit nënshkruan memorandum me Universitetin Bujqësor të Tiranës

Ruçi kujton kooperativat: Alergjia politike smund të pengojë ekonominë

"Konsolidimi i pronës bujqësore të përfundojë deri në 2021"

Darina Tanushi

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi bëri të ditur dje se po inkurajon qeverinë që procesi i konsolidimit të pronës bujqësore të përfundojë jo më vonë se viti 2021. Sipas tij, kjo masë do të ulë pasigurinë për pronën bujqësore. Ruçi ishte dje në Universitetin Bujqësor të Tiranës, ku nënshkroi memorandumun e bashkëpunimit midis Kuvendit të Shqipërisë dhe Universitetit Bujqësor të Tiranës, i cili ka për qëllim promovimin e punës kërkimore-shkencore. Gjatë fjalës së tij, në këtë aktivitet, kreu i Kuvendit kujtoi edhe organizimin e bujqësisë në kooperativa duke thënë: "Kooperimi në bujqësi është ende në nivele embrionike. 'Alergjia politike' ndaj ish-kooperativave nuk është më një argument që të pengojë logjikën racionale ekonomike të kooperimit dhe krijimin e ekonomisë së shpallës në bujqësi. Po ju risjell shprehjen që ekonomistët e njohin mirë: "Është ekonomia, o mirë!". U shpreh kreu i Kuvendit, duke kujtuar se kjo nuk ka të bëjë më me një term politik, por është çështje e zhvillimit ekonomik. "Gjatë termit qeverisës 2013-2017, sipërfaqja e tokës bujqësore nën sistemin e vaditjes u dyfishua, por ende ka mungesë të sistemeve të ujitjes. Kanalet dhe rezervuarët për ujitje duhet të mirëmbahen dhe kjo kërkon më shumë vëmendje e burime. Unë personalisht po këmbëngul që qeveria ta realizojë objektivin e saj programor që në vitin 2021 të ketë "Ujë në çdo parcelë" dhe, krahas vaditjes, të përmirësohet sistemi i kullimit për më decentralizim dhe rritjes së investimeve. Bujqësia e zhvillimi rural kërkojnë mbështetje edhe më të fuqishme nëpërmjet subvencioneve", u shpreh Ruçi më tej në fjalën e tij.

Ai tha se programi qeverisës, i miratuar nga Kuvendi, parashikon që në katër vitet e ardhshme për zhvillimin e zonave rurale do të financohen mbi 25 miliardë

lekë, me fokus mbështetjen e sektorit bujqësor, mbështetjen e fermerëve dhe rritjen e aksesit në tregje dhe përmirësimin e infrastrukturës. "Kuvendi - shtoi

Ruçi më tej - ka parashikuar dhe kalendari i kësaj mbështetjeje buxhetore, por edhe po kontrollojmë efikasitetin dhe ndikimin e saj për bujqësinë

dhe fermerët". "Ne po bëjmë kujdes që subvencionet dhe mbështetja për bujqësinë të shërbejë si incentiv e nxitje për rritjen e kooperimit, zhvillimin e ekonomisë së shpallës, rritjen e produktivitetit, konkurrencës dhe sigurisë ushqimore. Ne po bëjmë ligje, marrim masa e kontrollojmë qeverisjen që mbështetja financiare për bujqësinë të shkojë te fermerët, jo te seksorët e abuzuesit, që janë mësuar e lejuar të pasurohen duke grabitur fondet për mbështetjen e fshatarëve shqiptarë, që rraskapiten në vapë e në të ftohtë", theksoi kreu i Kuvendit.



Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi

Presidenti: Nuk preferoj të jap detaje nga takimi

Edi Rama i shkon Metës në zyrë, diskutohet marrëveshja me Greqinë

Kryeministri Edi Rama ku takua dje pasdite me Presidentin e Republikës, Ilir Meta, në Presidencë. Në takimin që zgjati gati 40 minuta, mësohet se është diskutuar në lidhje me vijimin e negociatave me palën greke për marrëveshjen e kufirit detar. Burimet bënë me dije se biseda është përgjendruar edhe tek shfuqizimi i Ligjit të Luftës, si dhe çështjet lidhur me të drejtat e emigrantëve atje. Shqipëria dhe Greqia kanë vendosur si afat përfundimtar për firmosjen e marrëveshjeve muajin qershor, ndërkohë që në datat 28-29 qershor pritet edhe një vendim i vendeve të Bashkimit Evropian për t'i dhënë ose jo të drejtën e çeljes së negociatave të bisedimit mes Shqipërisë dhe BE-së. Nga ana e saj, Greqia ka premtuar dhënie të mbështetjes. Po ashtu, mësohet se në qendër të bisedës ka qenë edhe çështja e teatrit, për të cilin presidenti ka kërkuar transparencë e



NEGOCIATAT

Në takimin që zgjati gati 40 minuta, mësohet se është diskutuar në lidhje me vijimin e negociatave me palën greke për marrëveshjen e kufirit detar. Burimet bënë me dije se biseda është përgjendruar edhe tek shfuqizimi i Ligjit të Luftës, si dhe çështjet lidhur me të drejtat e emigrantëve atje.

dialog nga qeveria. Presidenti Meta, i pranishëm në një festë të ambasada britanike në Tiranë, ka thënë për përfaqësuesit e medias se ka pasur një takim me Ramën këtë pasdite, por pa dhënë

detaje shtesë. "Ishte një takim me kryeministrin Edi Rama. Nuk preferoj të jap detaje", u shpreh Presidenti Meta. Ndërsa kryeministri Rama nuk ka folur për këtë takim.



Gjate një mbledhjeje të qeverisë

Ministria Xhaçka në Francë: Bashkëpunim me FA franceze për emergjencat civile

Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka u takua dje me ministrin e Forcës së Armatosur të Francës, Florence Parly. Ministria e Mbrojtjes ishte e ftuar nga homologia e saj franceze për të marrë pjesë në "Eurosatory 2018", ekspozita ndërkombëtare e mbrojtjes dhe sigurimit të tokës dhe ajrit. Në ekspozitën që zhvillohet çdo dy vjet marrin pjesë përfaqësues të industrive ushtarake të rreth 140 vendeve të botës, të cilët paraqesin oferta dhe mbledhin kërkesa për shërbimet e ofruara në fushën e mbrojtjes. Ministrat Xhaçka e Parly rikonfirmuan marrëdhënien shumë të mirë me Shqipërisë dhe Francën, veçanërisht në fushën e mbrojtjes, në të cilën dy vendet bashkëpunojnë prej vitesh. Kompania franceze "Nexter" ka pajisur me top 20 mm anijen shqiptare "Butrinti", e cila merr pjesë në operacionin e NATO-s në detin Egje dhe aktualisht po punon për pajisjen me këtë lloj armatimi edhe të anijeve të tjera të Forcës Detare shqiptare. Ministria Xhaçka shprehu interesin e Forcave të Armatosura shqiptare për të bashkëpunuar me Forcat e Armatosura franceze edhe në fushën e emergjencave civile. Në ekspozitën "Eurosatory", ministria Xhaçka vizitoi stendat dhe zhvilloi takime me përfaqësuesit e kompanive prestigjioze në fushën e industrisë ushtarake si "Lockeed Martin", "Nexter" dhe "Thales".



Rama, mesazh kundërshtarëve të Velierës, në Durrës: Do vini si diversantë ta vizitoni

Kryeministri Edi Rama prezantoi dje në Durrës projektet për këtë qytet. Në fjalën e tij, Rama nuk la pa bërë një mesazh për ata që kundërshtojnë ndërtimin dhe vitin e ardhshëm ta kemi gati. Turp i atyre që e kanë orkestruar po ashtu dhe ata që janë bërë palë me ata. Do vini me gjylykë e kapele si diversantë për ta vizituar. Se kështu bënë edhe me parkun e lodrave në ligenin artificial të Tiranës. Kështu bënë edhe me qendrën e Tiranës, po ashtu edhe me stadiumin kombëtar", tha Rama. "Ti orientojmë të reja e të rinjtë sa më shumë drejt arsimit profesional. Mund të bëhen gjatë rrugës edhe sipërmarrës të vegjël edhe sipërmarrës të mëdhenj. Pagat e ulëta në Shqipëri janë ende shumë të ulëta, por nuk është vetëm këtu, por në të gjithë rajonin, lidhet me kapacitetin e burimeve tona njerëzore, me prodhimtarinë e të tjerë, jemi krah pune më mungesë në aspektin e kualifikimeve", u shpreh më tej kryeministri.



Kryeministri Edi Rama, në një intervistë ekskluzive për "Anadolu Agency" (AA) ka folur në lidhje me marrëdhëniet Shqipëri-Turqi, partneritetin strategjik midis dy vendeve, përpjekjet e përbashkëta për të eliminuar kërcënimin e strukturave të organizatës terroriste FETO në Shqipëri, për çështjet e brendshme dhe rrugëtimin evropian të Shqipërisë, si dhe për zhvillimet në Kosovë dhe rajon. Duke folur mbi perspektivën europiane të Shqipërisë, kryeministri Rama theksoi se është një proces i afirmuar më shumë sesa me dekada në kuptimin, sipas tij, që prirja e Shqipërisë ka qenë një prirje natyrale drejt Europës. "Nga ana tjetër, nëse flasim konkretisht sot duhet të jemi të vetëdijshëm se nuk varet vetëm nga ne, se procesi i integrimit evropian është gjithmonë e më i ndërlikuar dhe njëkohësisht më i paparashikueshëm për shkak të vetë turbullirave të brendshme në vendet e Bashkimit Evropian dhe të erërave kundër zgjerimit dhe kundër vetë Bashkimit Evropian brenda disa vendeve të rëndësishme anëtare. Kështu që, për sa na takon, do të vazhdojmë punën tonë, pasi për ne procesi i integrimit evropian nuk është një udhëtim për t'u spostuar nga Tirana në Bruksel, por është një udhëtim brenda vetes për t'u modernizuar dhe për të pasur një shtet funksional të standardeve evropiane", tha Rama për AA. Ndërkohë, mes Shqipërisë dhe Greqisë janë mbajtur disa raunde të bisedimeve për kufizimin e zonave detare dhe për çështjet e hapura mes dy vendeve, ndër-
sa Rama shprehet se është optimist që më në fund do t'u japin drejtim disa proceseve të bartura prej 70 vjetësh mes dy vendeve dhe njëkohësisht disa problemeve, që herë pas herë sipas tij i gjejnë në rrugën e vendit për shkaqe të brendshme në Shqipëri apo Greqi. "Ka pasur një proces të vështirë për të arritur deri në uljen në tryezë, por besoj që ulja në tryezë do të dalë me një zhvillim pozitiv në marrëdhëniet mes vendeve tona dhe në respekt të dinjitetit të njëri-tjetrit", u shpreh kryeministri i Shqipërisë në lidhje me bisedimet Shqipëri-Greqi për çështjet e hapura mes dy vendeve.



Të rinjtë shqiptarë u bëjnë thirrje Francës, Gjermanisë e Holandës

"EU Policy Hub", një grup profesionistësh të rinj shqiptarë që monitorojnë dhe komunikojnë procesin e integrimit të Shqipërisë në BE u ka kërkuar shteteve anëtare si: Franca, Gjermania dhe Holanda të marrin në konsideratë rekomandimin e Komisionin Evropian për hapjen e negociatave të pranimit të Shqipërisë në BE. "EU Policy Hub" mbështet hapjen e bisedimeve të pranimit në BE dhe për këtë arsye u ka drejtuar një letër të hapur parlamenteve të Francës, Gjermanisë dhe Holandës, duke dhënë argumente se përse këto vende duhet të votojnë në favor të Shqipërisë gjatë Samitit të Këshillit të BE-së, që do të mbahet gjatë muajit qershor. Sipas "EU Policy Hub", dhënia e dritës së gjelbër në këtë moment kyç do të inkurajojë Shqipërinë që të punojë më shumë në miratimin, zbatimin e normave dhe standardeve të BE-së. "Si përfaqësues të të rinjve shqiptarë, ne besojmë fuqimisht që ky proces kërkuar mbetet çelësi për mbështetjen e shpresës sonë në integrimin evropian".

Kryeministri për "Anadolu Agency": Influenca negative e FETO-s të mos cenojë arsimin

Kamp për refugjatët, Rama: Fantazi, kemi qendër studimore antiterrorizëm

"Nuk do bëjmë atë që nuk e bëjnë vende më të pasura"



Kryeministri Edi Rama, gjatë intervistës për "Anadolu Agency" (AA)

AEROPORTI I VLORËS

Lidhur me investimet turke në Shqipëri, kryeministri Rama foli edhe mbi ndërtimin e aeroportit të ri ndërkombëtar të Vlorës, investim turk në vend, që pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2020. "Për sa i përket aeroportit të ri ndërkombëtar në Vlorë, ne jemi në një fazë të avancuar negociatash bazuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe synimi është që aeroporti të jetë gati përpara fundit të vitit 2020", tha Rama.

RAPORTET ME ERDOGANIN

"Marrëdhënia ime me presidentin (Erdogan) është një marrëdhënie që ka nisur pa u njohur unë me të, pasi e kam admiruar për së largu punën e tij të jashtëzakonshme si kryetar i Bashkisë së Stambollit dhe rolin transformues që ai ka pasur dhe ka qenë një ndër shembujt që më kanë frymëzuar për atë që kam bërë për Tiranën", tha Rama.

Gazeta gjermane: Shqipëria, një mundësi për vendprirjeje

Kamp për emigrantët në Shqipëri? Kancelari austriak, Kurz: Do ta shohim

Austria është duke udhëhequr përpjekjet për ndërtimin e një kampi për emigrantët jashtë territorit të BE-së. Kancelari austriak, Kurz pas takimit me ministrin e Brendshëm gjerman, Seehofer dha pak detaje për këto përpjekje kur u pyet nga mediat. "Austria po punon me një grup të vogël vendesh të BE-së për planin e ngritjes së qendrave të pritjes për refugjatët jashtë BE-së. Planet janë tejet konfidencialë për të rritur probabilitetin e realizimit të tyre", tha Sebastian Kurz, kancelar i Aus-



trisë. I pyetur direkt nga gazetarët gjermanë se a është Shqipëria vendi ku do të ngrihen një kamp i tillë, kryeministri Austris dha një përgjigje të shkurtër. "Do ta shohim" ishte përgji-

gja e tij. Gazeta gjermane "Der Spiegel", takimit të kryeministrit austriak Kurz me ministrin e Brendshëm gjerman, Seehofer i ka kushtuar një artikull nga ku vijon pyetjen: A është Shqipëria vendi i mundshëm? Përgjigjen e jep duke cituar mediat austriake dhe kryeministrin danez, që shohin Shqipërinë si një mundësi. E kështu, pavarësisht se kryeministri Edi Rama e mohoi krijimin e një kampi refugjatësh nga BE në Shqipëri, mediat gjermane shkruajnë se Shqipëria shihet si vendi më i mundshëm për krijimin e këtyre kampeve.

në një qendër rajonale, qendër ekselence që ka të bëjë me fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm dhe që trajton në rrugë të ndryshme këtë fenomen. Sipas tij, kjo nuk ka të bëjë asgjëkund me ndonjë koncept të një qendre në kuptimin e një qendre grumbullimi njerëzish dhe aq më pak pastaj me "konceptin krejtësisht të pavend dhe madje qesharacak të mbledhjes së gjithë ish-ushtarëve të ISIS-it (DEASH) në këtë qendër". "Pra, është thjesht një fantazi. Ndërkohë, sa i përket një kampi refugjatësh në funksion të Bashkimit Evropian këtu në Shqipëri, edhe kjo është

të një fantazi. Unë as nuk e kam dëgjuar ndonjëherë të artikullat dhe as nuk e kam menduar ndonjëherë se mund të ndodhë, ndërkohë që Shqipëria ka qenë dhe mbejt gjithmonë e një bindjeje që vendet e Bashkimit Evropian nuk mund t'ia hedhin topi njëri-tjetrit dhe ta lënë barrën e detyrimeve morale që ka Europa ndaj njerëzve që ikin nga vendet e tyre për shkak të kërcënimit të jetës. Secili duhet të marrë përgjegjësitë e veta dhe Shqipëria ka qenë e gatshme të marrë përgjegjësitë e veta, për aq sa i takon. Ne nuk kemi pasur asnjë propozim për të

bërë diçka të tillë dhe as nuk e kemi konsideruar një mundësi të tillë. Jemi të gatshëm të bëjmë çdo gjë bashkë me tjerët dhe të marrim pjesën që na takon, por nuk jemi të gatshëm që të bëjmë atë që të tjerët nuk duan ta bëjnë, duke qenë shumë më të pasur, duke qenë shumë më të fuqishëm se ne", tha Rama. **"NE JEMI TË PËRKUSHTUAR QË INFLUENCA NEGATIVE E FETO-S TË MOS CENOJË MISIONIN QË KA ARSIMI NË SHQIPËRI"** I pyetur për strukturat e organizatës terroriste FETO,

që veprojnë në Shqipëri, kryeministri Rama ka pohuar se ka një numër të caktuar shkollash të ndërtuara në të shkuarën, që kanë qenë një pikë referimi për prindërit dhe nxënësit. Siç thotë kryeministri shqiptar, shkollat e FETO-s në të kaluarën kanë ofruar mundësi që Shqipëria nuk është se i ka pasur në të gjithë sistemin në territorin e vet, por se aktualisht qeveria shqiptare është e përkushtuar që "influenca negative e këtyre shkollave" të mos ndikojë në arsimin në Shqipëri. "Është me shumë rëndësi të kuptohet se ne jemi të përkushtuar për të ofruar një shërbim sa më të mirë arsimor në të gjithë territorin dhe paralelisht patjetër për të mos lejuar që influenca negative të natyrës që ju përmendet (kërcënimit të FETO-s) të kenë hapësirë dhe të cenojnë pikërisht misionin që ka arsimi në Shqipëri", deklaroi kryeministri Rama për AA. I pyetur më tej për bashkëpunimin dhe përpjekjet midis Shqipërisë dhe Turqisë për të eliminuar kërcënimin e FETO-s, Rama duke iu referuar grusht shtetit të dështuar të FETO-s në Turqi, tha se ajo ngjarje i bën vigjilent dhe shumë të vëmendshëm, pasi siguria kombëtare dhe stabiliteti demokratik i vendit është prioriteti i prioritetëve. "Ne jemi shumë të vëmendshëm. Kemi të gjitha arsyet të mbelemi shumë të vendosur në qëndrimin e shprehur që në minutat e para të grusht shtetit se bëhej fjalë dhe bëhet fjalë për një kërcënim serioz, që ne nuk do të donim në asnjë mënyrë ta shikonim, në asnjë formë sado marginale në vendin tonë", tha kryeministri shqiptar.

"Denoncimi i Xhuljanës, efektivet s'kanë asnjë përgjegjësi penale"

Vrasja në "Don Bosko", SHÇBA kryen verifikimet: Policët, "të pastër"

Disa ditë pas krimit të dyfishtë në kryeqytet, ku Xhafer Mata vrau me armë zjarri ish-të dashurën, 19-vjeçaren Xhuljeta Çuni dhe më pas qëlloi veten, SHÇBA nisën verifikimin e të gjithë punonjësve të policisë që kanë trajtuar çështjen. Pas hetimeve të kryera, sipas SHÇBA, rezultoi se punonjësit nuk kanë pasur asnjë përgjegjësi penale për ngjarjen e ndodhur në "Don Bosko". Kujtojmë se viktimat Xhuljeta Çuni e kishte denoncuar autorin në komisaratin nr.3 për përndjekje, por sipas familjarëve të saj, policia nuk mori asnjë masë. "Struktura e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA), Tiranë nisi veri-

VERIFIKIMI

Nga të gjitha verifikimet e kryera ka rezultuar se policia ka marrë kallëzim në datën 7 maj 2018 nga shtetasja Xhuljeta Çuni për përndjekje. Materialet janë referuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pas kallëzimit, prokuroria nuk i ka deleguar veprime të tjera shtesë policisë, duke vijuar vetë me veprimet hetimore", thuhet në njoftimin e SHÇBA.

fikimet për veprimet apo mosveprimet e policisë, menjëherë me ngjarjes së ndodhur në datën 8 qershor 2018, në rrugën 'Don Bosko', ku shtetasi X.H.M. vrau me

armë zjarri shtetasen 19-vjeçare Xh.Ç. e më pas veten. SHÇBA kreu verifikimet e plota për të këqyruar veprimet policore, duke nisur me intervistimet e punon-

jësve, këqyrjen e librave të shërbimit, dokumentacionit, kamerave etj. Nga të gjitha verifikimet e kryera ka rezultuar se policia ka marrë kallëzim në datën 7 maj 2018 nga shtetasja X.H.Ç. për përndjekje. Materialet janë referuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pas vlerësimit të kallëzimit nga prokuroria, është bërë regjistrimi i procedimit penal, për të vijuar më pas me hetimin. Pas kallëzimit, prokuroria nuk i ka deleguar veprime të tjera shtesë policisë, duke vijuar



Xhuljeta Çuni dhe Xhafer Mata

vetë me veprimet hetimore", thuhet në njoftimin e SHÇBA. Mësohet se Policia e Shetit nuk ka marrë asnjë ankesë tjetër apo t'i jetë bërë prezent ndonjë shtetësim nga shtetasja Xhuljeta Çuni pas kallëzimit të datës 07.05.2018. Pra, nga veri-

fikimet e kryera nga SHÇBA dhe analizimi i dokumentacionit të administruar, nuk rezultoi se punonjësit e policisë që kanë trajtuar ngjarjen të kenë konsumuar elemente të ndonjë vepre penale, duke shpërdoruar detyrën.

Avokati: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit të lërë komentet dhe të prezantojë faktet

Vetingu, konfirmohet në detyrë kreu i Gjykatës Kushtetuese, Bashkim Dedja

KPK: Nuk ka shkelje dhe fshehje të pasurisë

Ina Allkanjari

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit i konfirmoi ditën e djeshme në detyrë kreu e Gjykatës Kushtetuese, Bashkim Dedja. Gjyqtari i Kushtetueses doli "i pastër" nga vetingu. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit deklaroi se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe verifikimeve që ka bërë, ka vendosur konfirmimin e tij në detyrë.

Trupa gjyqësore, e cila përbëhej nga Sanxhaktari, Roland Ilira dhe Xhensila Pine u shprehën se nga verifikimi i ILDKPKI dhe i vetë komisionit ka rezultuar se gjyqtari nuk ka shkelje dhe fshehje të pasurisë. Kreu i Gjykatës Kushtetuese nuk ndodhej i pranishëm në seancë, ndërsa përfaqësohej nga avokati Maks Haxhia. Avokati kishte paraqitur dy kërkesa, por që nuk u morën parasysh. "Pas përfundimit të seancës së parë, në adresë të komisionit erdhën dy kërkesa, të cilat ky i fundit ka vendosur të mos i marrë në konsideratë. Trupa shqyrtoi të gjithë dokumentacionin, dëgjoi zotin Haxhia dhe vendosi me shumicë votash që të konfirmojë në detyrë zotin Bashkim Dedja", njoftoi trupa gjyqësore. Më herët gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar më datë 8 qershor u konstatua se Bashkim Dedja nuk justifikonte një shumë prej 15 mijë eurosh, të cilën e kishte marrë hua nga vëllai i tij. Ndërkohë, në seancën e kësaj të mërkure, relatorja e Ko-



Kreu i Gjykatës Kushtetuese, Bashkim Dedja

misionit të Pavarur të Kualifikimit lexoi vetëm vendimin, pa dhënë detaje mbi huan që kreu i Gjykatës Kushtetuese i kishte marrë vëllait të tij. Sipas KPK-së, Dedja kishte paqartësi dhe para të pajustificuara në deklaratat e pasurive. Ato kanë të bëjnë me huan për blerjen e një apartamenti në Tiranë, me sipërfaqe 146 metra katrorë. Relatorja e komisionit, Xhensila Pine tha se është kryer hetim për deklarimet e pasurisë së Bashkim Dedes: "Apartament banimi 146 m katrorë, garazh me vlerë 118 mijë euro. Burimi i këtyre aseteve janë kredi bankare 120 mijë euro me afat 20 vjet. Hua pa interes 25 mijë euro. Të ardhurat e tij, 35 mijë euro bashkë me bashkëshorten. Vlera e apartamentit është 180 mijë euro". Bashkim Dedja ka bërë dy deklarata materiale të dyshimit: 15 mijë euro hua nga vëllai, 25 mijë euro

për të cilat deklaroi se ia kishte marrë kunatit, e më pas babait të kunatit. Probleme janë vërejtur edhe me pronësinë e një apartamen-

Vendimi

"Pas përfundimit të seancës së parë, në adresë të komisionit erdhën dy kërkesa, që komisioni ka vendosur të mos i marrë në konsideratë. Trupa shqyrtoi të gjithë dokumentacionin, dëgjoi zotin Haxhia dhe vendosi me



Avokati Maks Haxhia

ti 98 metra katrorë në Tiranë, i cili është deklaruar në vitin 2003 në bashkëpronësi mes Dedjas dhe njërit prej vëllezërve të tij, në masën 50 me 50. Më pas, Dedja, në deklaratën për llogari të vetingut ka deklaruar se apartamenti është i tiji 100%. Në lidhje me këtë, avokati sqaroi se vëllai i gjyqtarit, Mensur Dedja nuk ka marrë kurrë në jetën e tij kredi, por apartamentin e tij e ka vënë si kolateral në emër të nipit të tij. "Pavarësisht se vendimi ishte në favor të kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, në seancën e shkuar u bë një prezantim në kundërshtim me atë të relatorës. Rehatoja nuk mund të bëjë komente, por ishte zgjedha e saj. Relatorja bëri një prezantim duke thënë se në kohën kur i vëllai i ka dhënë 15 euro, ajo tha se korrespondonte me një periudhë kur ai ka marrë kredi 40 mijë euro. Ajo tha

se si ka mundësi që një njeri që jep borxh, jep edhe kredi. Pasi mbaroi seanca kontaktuam me vëllain e Bashkimit, që tha se nuk ka marrë asnjëherë kredi. Pas këtij konstatimi, në bëmë kërkesë për rivefikim të këtij detaji, ku ose kishte një person tjetër me këtë emër, ose ishte informacion i gabuar. KPK duhet t'u shkojë deri në fund fakteve. KPK duhet të jetë shumë e kujdesshme, ata që janë pjesë e saj duhet të jenë të kualifikuar dhe të kenë dy gjëra: solemnitetin dhe seriozitetin. Nga verifikimet tona rezultoi se nuk ka person tjetër me këtë emër, por vëllai i Bashkimit, Mensuri, e ka vënë një apartament si kolateral për nipin e tij në bankë. Të dhënave duhet patjetër t'u shkohet deri në fund. Unë mund të vë kolateral për veten, por edhe për njerëzit e mi. U cenua në publik figura e personit më korrekt të sistemit

AVOKATI

"Pavarësisht se vendimi ishte në favor të kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, në seancën e shkuar u bë një prezantim në kundërshtim me atë të relatorës. Relatorja bëri një prezantim, duke thënë se koha kur i vëllai i ka dhënë 15 euro korrespondonte me një periudhë kur ai ka marrë kredi 40 mijë euro. Pasi mbaroi seanca, kontaktuam me vëllain e Bashkimit, i cili tha se nuk ka marrë asnjëherë kredi", u shpreh avokati.

të drejtësisë", u shpreh avokati Maks Haxhia. Bashkim Dedja është gjyqtar që prej vitit 1993 dhe drejton Gjykatën Kushtetuese që nga viti 2012. Bashkim Dedja dhe Vitore Tusha janë të vetmit nga Gjykata Kushtetuese që kanë kaluar me sukses procesin e vetingut. Më parë nga Gjykata Kushtetuese u shkarkuan për mosjustifikim të pasurive anëtarët Fatos Lulo, Altina Xhoxhaj dhe Fatmir Hoxha, ndërsa ka dhënë dorëheqje Besnik Imeraj përpara nisjes së procesit.

Çështja e emrit, Kotcias: Duam që vendimi të pranohet nga të dy popujt

"Maqedonia e Veriut", Cipras: Fitore e madhe diplomatike

Zaev: Marrëveshja hap perspektivën europiane për ne

Kjo është "një fitore e madhe diplomatike, por edhe një shans i madh historik", deklaroi kryeministri grek Alexis Cipras në një fjalim të transmetuar në televizion të martën në mbrëmje. Sido që të jetë "fqinjët e veriut" kanë rënë dakord ta quajnë vendin e tyre "Maqedonia e Veriut" (Severna Makedonija). Ky emër, shtoi Cipras, vlen "erga omnes" (për të gjithë). Që do të thotë jo vetëm Greqia, por të gjitha vendet e botës dhe ka një njohur tashmë shtetin e ri me emrin e ankoruar në kushtetutë si "Republika e Maqedonisë". Nga ana tjetër, kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev ka dhënë detaje për arritjen e marrëveshjes për emrin. Emri i ri i Maqedonisë "Republika e Maqedonisë së Veriut" do të jetë i përkthyeshem dhe për përdorim të përgjithshëm, ka thënë Zaev. Kryeministri i Maqedonisë Zoran Zaev është shprehur se zgjidhja e çështjes së emrit është një marrëveshje historike, e cila i hap rrugë integrimit të vendit në Bashkimin Europian dhe në NATO. Zaev ka deklaruar se për marrëveshjen do të merret qëndrimi i qytetarëve në referendum. "Ne kemi një zgjidhje historike shekullore, zgjidhjen e mosmarrëveshjes, ndërtimin e miqësisë mes dy vendeve. Vendimi për të forcuar identitetin maqedonas, kombin maqedonas, mbrojtur dhe forcuar edhe një herë. Me këtë marrëveshje do të kemi identitetin, gjuhën dhe kulturën tonë. Kjo marrëveshje do të konfirmojë



Alexis Cipras

ZORAN ZAEV

"Ne kemi një zgjidhje historike shekullore, zgjidhjen e mosmarrëveshjes, ndërtimin e miqësisë mes dy vendeve. Me këtë marrëveshje do të kemi identitetin, gjuhën dhe kulturën tonë. Kjo marrëveshje do të konfirmojë dhe forcëjë identitetin tonë kulturor. Nga sot emri i ri i do të jetë "Republika e Maqedonisë së Veriut", - ka thënë kryeministri i Maqedonisë Zoran Zaev.

dhe forcëjë identitetin tonë kulturor. Nga sot emri i ri do të jetë "Republika e Maqedonisë së Veriut", ka deklaruar kryeministri i Maqedonisë Zoran Zaev. Gjithashtu, Greqia do t'i dërgojë letër institucioneve ndërkombëtare për t'i informuar për arritjen e marrëveshjes, hap që do t'i hapë rrugët Maqedonisë për një datë të mundshme për fillimin e bisedimeve për anëtarësim në BE-në dhe ftesë të drejt-

përdrejtë për anëtarësim në NATO. Sipas mediave greke njoftimet që nuk janë konfirmuar ende thonë, se Alexis Cipras dhe kolegu i tij maqedonas Zoran Zaev do të takohen ditët e ardhshme në Ligenin e Prespës, në trekëndëshin midis Greqisë, Shqipërisë dhe Maqedonisë, për të nënshkruar marrëveshjen dhe për të filluar një epokë të re bashkëpunimi. Më parë ministri i Jashtëm maqedon Nikola

NIKOS KOTCIAS

"Ne na duhet një marrëveshje, që mund t'i rezistojë kohës dhe që pranohet nga të dy popujt", - tha kryediplomati grek. "Ne nuk duam t'i bëjmë një vendi të vogël çfarë na kanë bërë të tjerët neve." Por Kotcias nuk thotë për kë e ka fjalën. Sidoqoftë ai u tregua i kënaqur nga rezultati i bisedimeve: Greqia fitoi në disa gjëra, që janë "pretendimet e saj për territorin, njohjen e kufijve ekzistues, qëndrimin ndaj spekulimeve mbi një pakicë këtu në vend dhe efektin erga-omnes". Kjo mbetet konsekuente nëse edhe pala tjetër përfiton diçka, thotë Kotcias. Grindja për emrin ka 25 vjet që vazhdon. Mbas shpërbërjes së Jugosllavisë më 1991, shteti në veri të Greqisë ka shpallur pavarësinë me emrin "Republika e Maqedonisë".

Dimitrov bëri një vizitë të shkurtër në Berlin. Se si e përfytyron të gjithë këtë ministri i Jashtëm grek Nikos Kotcias, e shpjegoi në emisionin televiziv "Kontra Channel" ditën e hënë. "Ne

na duhet një marrëveshje, që mund t'i rezistojë kohës dhe që pranohet nga të dy popujt", - tha kryediplomati grek. "Ne nuk duam t'i bëjmë një vendi të vogël çfarë na kanë bërë të tjerët neve." Por Kotcias nuk thotë për kë e ka fjalën. Sidoqoftë ai u tregua i kënaqur nga rezultati i bisedimeve: Greqia fitoi në disa gjëra, që janë "pretendimet e saj për territorin, njohjen e kufijve ekzistues, qëndrimin ndaj spekulimeve mbi një pakicë këtu në vend dhe efektin erga-omnes". Kjo mbetet konsekuente nëse edhe pala tjetër përfiton diçka, thotë Kotcias. Grindja për emrin ka 25 vjet që vazhdon. Mbas shpërbërjes së Jugosllavisë më 1991, shteti në veri të Greqisë ka shpallur pavarësinë me emrin "Republika e Maqedonisë".



Çepurin: Krimeja është Rusi, Kosova është Serbi

Diplomati serb, Jeremić: Vuçiç planifikon trazira në pjesën veriore të Mitrovicës

Krimeja është Rusi e Kosova është Serbi. Kjo nuk është vetëm parullë, ky është realitet juridik që duhet të respektohet", ka deklaruar Aleksandar Çepurin, ambasador i Rusisë në Beograd. Për gazetën e Beogradit "Politika" ai ka thënë se në kohë të fundit, por bëhen paralele ndërmjet Kosovës dhe Krimesë, porse, ka shtuar ai, Krimeja dhe Kosova janë tregime krejtësisht të ndryshme. "Së paku për shkak të asaj se Kosova i është marrë Serbisë pa respektim të Deklaratës për të drejtën ndërkombëtare të KB-së të vitit 1970, ndërsa Krimeja është shpërndarë në përputhje me parimet e kësaj Deklarate", -ka thënë ai, shkruan "Express". Ka shtuar se Kosova është marrë nga Serbia përmes "puçit të NATO-s". Ambasadori thotë se është e mundshme një kyçje me e madhe e Rusisë në "problemin e Kosovës", duke shtuar se kështu do të ndodhë nëse Serbia dëshiron. "Qëndrimi ynë mbetet i pandryshuar, përkrahim vendimin që e merr populli serb për Kosovën", -ka thënë në fund Çepurin. Ndërkohë që nga ana tjetër ish-ministri i Jashtëm, Vuk Jeremić ka deklaruar se Aleksandar Vuçiç është duke planifikuar që gjatë muajve të ardhshëm të shkaktojë trazira në pjesën veriore të Mitrovicës, me qëllim që marrëveshja me Prishtinën, që nënkupton anëtarësimin në OKB, të përjetohet disi më lehtë, shkruajnë mediat serbe. Jeremić, gjithashtu, është i bindur se qeveria aktuale po e mban Serbinë "de fakto të okupuar", duke akuzuar drejtëpërdrejt për këtë Vuçiçin, transmeton "Telegraf". Sipas Jeremić, qeveria aktuale në Serbi në llogari të çështjes së Kosovës, si shpërbërjen përkrahjen ndërkombëtare, transmeton "Telegraf". Vuk, gjithashtu, beson se Vuçiçit po t'i jep mundësia ta "shet" Kosovën, do ta bënte në këmbim të anëtarësimit të Serbisë në NATO.



SHKURT

Plas sherri për emigrantët, si reagon Italia dhe Franca

Mendohet se samiti që u zhvillua të premten në Paris mes liderëve të Gjermanisë, Francës dhe Italisë rrezikon të dështojë. Shkak janë bërë kritikët e ashpër që presidenti francez Emanuel Makron i bëri qeverisë italiane pas vendimit për mbylljen e porteve për emigrantët ilegalë. Shefi i Elizësë e quajti të martën qeverinë e Xhuzepe Kontes, "cinike dhe të papërgjegjshme". Më i ashpri në reagim ishte zv/kryeministri italian Mateo Salvini, i cili kërkoi që Konte të mos shkojë në takim me Merkelin dhe Makronin. Ministri i Jashtëm italian, Enco Moavero Milanezi, thirrri për sqarim ambasadorin francez në Romë. Ai i bëri thirrje qeverisë franceze të kërkojë ndjesë për etiketimet. Sipas kryediplomatit italian, refuzimi i ankorimit anijes me mbi 600 emigrantë ilegalë nga autoritetet italiane kishte për qëllim të zgjonte reagimin e Bashkimit Europian që e ka lënë të vetme Italinë në përballim me kësaj krize. Në mbështetje të Italisë për këtë rast doli kancelarja gjermane Angela Merkel. Përmes një deklarate për shtyp, shejfa e qeverisë së Berlinit i bëri thirrje Brukselit për reagim të menjëhershëm në mbështetje të Italisë.

Samiti Trump-Kim, Kremlini përsëritet fillimin e një dialogu të drejtëpërdrejtë

Ditën e djeshme Kremlini përsëriti fillimin e një dialogu të drejtëpërdrejtë midis SHBA-së dhe Koresë së Veriut, pas takimit të parë mes Donald Trump dhe Kim Jong-un, duke paralajmëruar se kriza koreano-veriore s'mund të zgjidhet për një orë. "Mundet vetëm të përsërisim faktin e arritjes së një takimi të tillë dhe fillimin e një dialogu të drejtëpërdrejtë", -u shpreh në një komunikatë për shtyp zhënësi i Kremilit, Dmitri Peskov. "Çilatdo qoftë rezultatet e takimeve të tilla, ato pa dyshim ndihmojnë në zbutjen e tensioneve në gadishull dhe kjo gjë ngjall vetëm kënaqësi", -theksoi ai. Ai theksoi, gjithashtu, pozicionin e Rusisë, sipas së cilës e vetmja rrugë e mundshme për të zgjidhur krizën bërthamore koreano-veriore ishte ajo e një dialogu të drejtëpërdrejtë. Donald Trump dhe Kim Jong-un zhvilluan të martën një takim historik në Singapor që u finalizua me nënshkrimin e një deklarate të përbashkët pa një progres të dukshëm për çështjen e mprehtë të arsenalit bërthamor të Koresë së Veriut.

**INSTITUTE OF STATISTICS OF ALBANIA
TENDER NOTIFICATION**

Institute of Statistics of Albania intends to award a supply contract for "Consumables (spare parts for server room equipment)" in Tirana, Albania, with financial assistance from Sweden, represented by the Swedish International Development Cooperation Agency (Sida) under the project: Direct funding for procurement of IT-equipment and establishing a training centre, with Sida contribution nr: 55020289. The tender dossier is available at (<http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/>), from **June 05, 2018**. The deadline for submission of tenders is: **June 19, 2018, time 16:00 hrs**, at Institute of Statistics of Albania, Blv. "Zhan D'Ark", No. 3, Tirana, Albania. Possible additional information or clarifications/questions shall be published on the <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/>. Tenderers may request clarification on any of the documents of the Tender up to the date of submission of offers.

**INSTITUTI I STATISTIKAVE
NJOFITIM TENDERI**

Në kuadër të projektit: "Financim direkt për prokurimin e pajisjeve të IT-së dhe ngritjen e qendrës së trajnimit, "Sida contribution nr: 55020289", financuar nga qeveria Suedeze, e përfaqësuar nga Agjensia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), Instituti i Statistikave (INSTAT), Tiranë, do të zhvillojë procedurën e prokurimit me objekt: Konsumable (pjesë ndërrimi) për pajisjet e dhomës së serverave". Dokumentat e tenderit mund t'i gjeni në adresën: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/>, nga data 05.06.2018. Afati i fundit i dorëzimit të ofertave është: **19.06.2018, ora 16:00**, në adresën: Instituti i Statistikave, Blv. "Zhan D'Ark", Nr. 3, Tiranë. Informacionet shtesë ose sqarime/pyetje, do të publikohen në: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/>. Kërkesa për sqarime mund të dorëzohen pranë Autoritetit Kontraktor, deri në ditën e fundit për dorëzimin e ofertave.

Ngjarja e 27 korrikut të 2017-ës, Lani dhe Olen Boraj u prangosën në prokurori

Morën peng 46-vjeçar, arrestohen dy vëllezër

S. Braçaj u torturua në makinë dhe në pyll për borxhin e ish-gruas

Ervis Kuçi

FIER

Dy vëllezër, të cilët ishin në kërkim që prej një viti u arrestuan dhe nga policia e Fierit. Bëhet fjalë për 37-vjeçar Lani Boraj dhe 31-vjeçar Olen Boraj, banues në Ksamil. Ata akuzohen se kanë marrë peng dhe kanë dhunuar një 46-vjeçar për një borxh që kishte marrë ish-gruaja e këtij të fundit. Sipas bluve, dy vëllezërit akuzohen për veprat penale "Heqje e paligjshme e lirisë", "Armëmbajtje pa leje" dhe "Vetëgjyqësi". Shkak i dhunimit me pasojë shkaktimin e shembjeve të kokës, tronditje të trurit dhe në fytyrë të S. Braçes, mësohet të ketë qenë një borxh që ish-bashkëshortja e tij u kishte marrë dy vëllezërve Boraj. Nga hetimet e organit të akuzës ka rezultuar se të ndaluarit i kishin dhënë ish-bashkëshortes së Braçes një shumë prej 1600



Foto ilustruese

eurosh dhe 30 mijë lekësh. Vëllezërit Boraj e kanë takuar disa herë Braçen duke i kërkuar që t'u kthente paratë. Por, ai ka thënë se nuk kishte dijeni për këtë borxh, pasi me bashkëshorten ishte divorcuar dhe nuk kishte dijeni për paratë që ajo u kishte marrë se nuk mund të mbante përgjegjësi për veprimet e saj. Por, vëllezërit Boraj kanë

këmbëngulur dhe dyshohet se e kanë kërcënuar Braçen, duke i thënë se nëse nuk u kthente paratë që u kishte marrë ish-gruaja e tij deri më datë 27 korrik 2017, do të kishin probleme. Gjithashtu, nga hetimet ka rezultuar se ish-gruaja e Braçes, pak kohë pasi u kishte marrë paratë borxh vëllezërve Boraj, më datë 21 shkurt të vitit 2017,

PRANGA NË PROKURORI

Dy vëllezërit Boraj ishin shpallur në kërkim që vitin e kaluar. Pas një thirrjeje të prokurorit të çështjes për t'u paraqitur, ata kanë mbërritur në organin e akuzës të shoqëruar nga avokati i tyre. E ndërsa janë njohur me akuzat dhe masën e sigurisë, Lani dhe Olen Boraj janë prangosur në ambientet e Prokurorisë së Fierit, ku kanë mbërritur me këmbët e tyre.

PENG-MARRJA

Ngjarja për të cilën akuzohen dy vëllezërit Lani dhe Olen Boraj ka ndodhur më 17 korrik të vitit 2017, në fshatin Hekal të Mallakastrës. Më datën e kësaj date, i dëmtuari S. Braçe që punonte në Bashkinë Mallakastër është telefonuar nga Lani Boraj, i cili i ka kërkuar që të shkonte me të në makinë, pasi do iknin në fshatin Hekal. Pasi i dëmtuari ka hipur në makinë, ka konstatuar se në sedilen e parë të mjetit ndodhej edhe vëllai i Lanit, Olen Boraj. Nga hetimet e Prokurorisë së Fierit është konkluduar se fillimisht biseda ka qenë normale, por kur S. Braçe ka nxjerrë telefonin për të kryer një telefonatë, Oleni ia ka tërhequr nga dora duke ia marrë me forcë dhe i ka folur me ton kërcënues se kur do t'ua jepte paratë. Në të njëjtën kohë dy-

shohet se e ka qëlluar me kokë në pjesën e vetullës së djathtë të dëmtuarin. Pasi S. Braçe është përballur me veprimet e dhunshme, ka hapur derën e mjetit dhe në lëvizje e sipër ka tentuar të hidhet në tokë, por pa mundur, pasi një këmbë i është bllokuar brenda mjetit. Në këtë moment vëllezërit Boraj akuzohen se kanë ndaluar mjetin dhe e kanë qëlluar me grushte e shkelma në trup e në kokë të dëmtuarin. Pas kësaj, ata e kanë futur sërish në makinë me forcë dhe e kanë shkuar në një pyll, edhe pse S. Braçe u lutej ta zbrisnin në tokë. Në mes të pyllit, të prangosurit kanë ndaluar mjetin dhe kanë nisur të godisnin sërish e ta kërcënonin në lidhje me vajzën, me të cilën jeton pas divorcit me të shogën. Autorët e kanë hedhur nga dora duke ia marrë me forcë dhe i ka folur me ton kërcënues se kur do t'ua jepte paratë. Në të njëjtën kohë dy-

na e ushtruar; i dëmtuari ka rënë pa ndjenja. Në deklaratim të tij, S. Braçe sqaron se kujtohet vetëm kur dy vëllezërit Boraj e kanë hedhur nga makina në hyrjen e pallatit ku jeton. Fillimisht ai ka pasur frikë të denoncimit rastin dhe ka qenë vajza e tij që e ka mjekuar, por pas disa orësh është detyruar të shkonte në spital, ku ka marrë mjekim për shtatë ditë. Pas nisjes së hetimeve, prokurori i çështjes, Petrit Vukaj kërkuar verifikimin e tabulateve telefonike të dy vëllezërve Boraj, nga ku ka rezultuar se ditën e ngjarjes, ata kanë përkrahur të njëjtën rrugë dhe janë gjendur në të njëjtat vende ku ka deklaruar i dëmtuari Braçe. Nga kontrolli i ushtruar në banesën e të ndaluarve, në fshatin Hekal të Mallakastrës, në prani të nënës së tyre, janë gjetur dhe sekuestruar tre krehra pistolette "TT", ku gjendeshin disa fishekë. Dy vëllezërit Boraj ishin shpallur në kërkim që vitin e kaluar. Pas një thirrjeje të prokurorit të çështjes për t'u paraqitur, ata kanë mbërritur në organin e akuzës të shoqëruar nga avokati i tyre. E ndërsa janë njohur me akuzat dhe masën e sigurisë, Lani dhe Olen Boraj janë prangosur në ambientet e Prokurorisë së Fierit, ku kanë mbërritur me këmbët e tyre.

Njoftim i shoqërisë Vodafone Albania Sh.A.

Të nderuar Klientë,

Vodafone Albania ju njofton se duke filluar nga data **2 Korrik 2018**, do të ofrojë pesë paketa të reja standarte me vlefshmëri **30 ditë** për pajtimtarët me parapagesë të planit tarifor Vodafone Club, të cilat do të zëvendësojnë paketat aktuale standarte, si më poshtë:

	Vodafone Talk	Vodafone Combo	Vodafone Z	Vodafone Silver	Vodafone Gold
Minuta Kombëtare	200	2,500	400	3,000	3,500
Minuta drejt rrjeteve fikse					
Minuta ndërkombëtare				10	60
Internet	200 MB	2 GB	5.5 GB	5.5 GB	12 GB
Përfitimtë tjera			10 GB Social & Chat		
SMS brenda rrjetit Vodafone	200	2,000	400	2,500	3,000
SMS kombëtare		200		300	400
SMS ndërkombëtare					
Vlefshmëria	30 ditë	30 ditë	30 ditë	30 ditë	30 ditë
Cmimi (me TVSH)	800 Lekë	1200 Lekë	1500 Lekë	1500 Lekë	2200 Lekë

Paketat 30 ditore standarte Club Basic, Club Superior, Club GigaDepo, Club Extra dhe Club Elite nuk do të ofrohen më në treg.

Klientët me parapagesë, të cilët do të kenë aktive një nga paketat standarte në momentin e ndryshimit, do ta përdorin atë të pandryshuar deri në përfundimin e vlefshmërisë së saj.

Për më shumë informacion telefononi 140, vizitoni vodafone.al ose dyqanet Vodafone.



Vdekja e 16-vjeçares Anagnosti, arrestohet taksisti Spiro Papa, që e transportoi nga Saranda në Janinë

GREQI - Gjykata e Janinës ka vendosur dje masën "Arrest me burg" për taksistin Spiro Papa, i cili shoqëroi me makinë 16-vjeçaren Konstandina Anagnostin që humbi jetën në nëntor të vitit 2014. Mediat greke raportojnë se prokurori i çështjes kërkoi që taksisti të qëndrojë në qeli deri sa të zbardhet ngjarja, kërkesë e cila u pranua nga gjykata. Nuk dihet nëse autoritetet e Janinës kanë prova të reja në lidhje me hetimin e nisur katër vite më parë. Mësohet se para dy ditësh, Prokuroria e Janinës thirrë 7 dëshmitarë, mes tyre edhe nënën e dhe motrën e minorones, e cila humbi jetën në rrethana të misterhme. Taksisti që u la në burg ka deklaruar pas ngjarjes se më 15 nëntor të 2014-ës, se ai dhe Konstandina Anagnosti fillimisht shkuan tek dentisti në Sarandë. Gjatë kthimit për në Janinë ku banonte me të ëmën, 16-vjeçarja humbi ndjenjat në makinë dhe mbërriti pa jetë në spital. Ekspertiza mjekoligjore në Shqipëri doli në konkluzionin se vajza humbi jetën nga shkaqe natyrore



I arrestuari Spiro Papa



16-vjeçarja Konstandina Anagnosti

dhe për rrjedhojë pushoi hetimet. Por, babai i vajzës, Jorgo Anagnosti s'pranoi rezultatet e hetimeve në Shqipëri. Ai bëri denoncim në Janinë, ku hetimet aty dolën me të tjera konkluzione. Më 23 mars 2018, mjeku grek që bëri autopsinë e minorones tha se Konstandina Anagnosti i ishin hequr organet vitale në mënyrë joprofesionale dhe jashtë çdo standardi të mjekësisë ligjore. Sipas tij, nga trupi i 16-vjeçares mungonte baza e gjuhës, epiglottisi, trakeja, laringu, mitra dhe truri. Kurse në gjakun dhe në analizat e urinës që iu bënë, u konstatuan sasi të larta të

likoidinës (lloj anestezie). Mjeku-ligjor i Universitetit të Janinës ishte habitur nga metoda joprofesionale e ekspertizës që i ishte bërë 16-vjeçares në Shqipëri. Ai madje ka kërkuar para hetuesve grekë edhe bërjen e një testi gjenetik për t'u identifikuar organet që pala shqiptare ka dërguar për analizë në Greqi. Gjatë gjithë kësaj kohe nga dita që iku nga jeta Konstandina, i ati, Jorgo Anagnosti ka filluar një luftë të madhe për drejtësi. Ai kërkoi zbardhjen e së vërtetës së vdekjes të së bijës dhe të ndëshkohen nga ligji personat përgjegjës.

Dritan Meçani: Shteti të më ndihmojë të sjell trupin e pajetë, kërkoj drejtësi

Vdekja tragjike e 20-vjeçares në Torino, babai: Iku me një djalë në Itali

"Para 5 muajsh Anxhelës i vdiq e ëma, nuk erdhi në varrim se nuk kishte dokumente"

Ervis Kuçi

FIER

Vrasja makabre e 20-vjeçares Anxhela Meçani ka tronditur familjarët e saj. Pak ditë pas ngjarjes së ndodhur në Torino të Italisë, ku e reja e dhunua barbarisht deri në vdekje dhe më pas u hodh nga makina, ka reaguar babai i viktimës, Dritan Meçani nga Gjirokastra. Mes dhimbjes së madhe, ai ka kërkuar drejtësi dhe zbardhjen sa më shpejt të ngjarjes. "Gazeta Shqiptare" kontaktoi me të atin e 20-vjeçares në fshatin Baltëz të Fierit, në banesën e vjehrrit të tij. Përmes lotëve, 50-vjeçari, baba i katër fëmijëve tha se e bija kishte ikur në Itali më 17 dhjetor të vitit që shkoi me një djalë shqiptar dhe më pas atje, ajo ishte martuar me një italian të madh në moshë. Ndërkohë, Meçani bëri apel për ndihmë. "Përveç humbjes tragjike të vajzës, kam një hall të madh. Nuk kam mundësi financiare të tërheq trupin e pajetë të vajzës e ta sjell në Shqipëri. Shteti të vejë dorën në zemër dhe të më ndihmojë, pasi kam dhe tre fëmijë të tjerë për të rritur", u shpreh Dritan Meçani. Ndërkaq, ai tregoi se para pesë muajsh ka humbur dhe bashkëshorten me origjinë nga Fieri. Në një intervistë për "GSH", babai i Anxhelës Meçani tregoi se i e mësoi lajmin tragjik për vrasjen e të bijës.

Si e morët vesh vdekjen e vajzës?

E morëm vesh nga televizioni dhe interneti. Vajza tjetër e pa dhe më tha se emri i motrës së saj ishte në internet dhe se vajza ishte vrarë. Shkova në polici, ku më morën disa të dhëna. Ata e nxorën në sistem që Anxhela kishte ikur në Itali më 17 dhjetor të vitit 2017, pasi unë kisha dalë nga spitali. Mora kontakt me ambasadinë shqiptare në Itali. Më thanë se vajza ishte vrarë në Torino dhe se duhet të tërhiqim trupin. Por, ne nuk kemi mundësi financiare. Unë kam ekonomitë të dobët. Bashkë me vajzën që ma vranë, kam 4 fëmijë. Ndërsa, bashkëshortja më ka vdekur para 5 muajsh. Në krye të 5 muajsh më vdiq edhe vajza. Dua që ambasada të më sjellë vajzën, s'dua të më ngejë trupi i saj në Itali.

Me kë shkoi Anxhela në Itali?

Ajo thoshte se kishte një të dashur, por ne nuk e kemi njohur atë. Kaq. Ai nuk mori ndonjëherë në telefon, apo të kishte kontakt me ne.

Thuhet se vajza juaj kishte lidhur marrëveshje Itali, çfarë dini në lidhje me këtë?

Ajo thoshte që kishte lidhur martesë me një italian, pak në moshë të madhe për dokumente. Nuk di çfarë të them. Vajza nuk ka ardhur në Shqipëri kur i vdiq e ëma, pasi nuk kishte dokumente.

Me dëshirën e saj u lar-



Viktima Anxhela Meçani



Babai i 20-vjeçares Dritan Meçani, duke folur për "GSH"



GJYSHI I VIKTIMËS

Isa Veizaj, gjyshi nga nëna i 20-vjeçares Anxhela Meçani është tejet i tronditur nga vrasja tragjike e së mbesës. "Mbesa iku në Itali me të dashurin nga Fieri. Më pas ajo na tha se ishte martuar me një italian për dokumente. Ne kërkojmë të zbardhet e vërteta", tha i moshuari. Ndërkaq, Veizaj tregoi se Anxhelën e ka parë për herë të fundit në tetor të vitit të kaluar. "Kishim dasmën e nipit. Anxhela erdhi 10 minuta dhe iku. Nuk pata shumë kohë të bisedoja me të, pasi mendova se do të rrinte. Dua që shteti shqiptar të vëre dorën në zemër dhe të na ndihmojë për të sjellë trupin e saj", deklaroi gjyshi i viktimës.

E reja, e martuar me "100-vjeçar" italian për dokumente

Biseda audio/ Tezja e Anxhelës i kërkon llogari djalit që e çoi në Itali: Do gjykoresh vetëm ti..

ITALI - Vdekja tragjike e 20-vjeçares shqiptare në Itali, Anxhela Meçani është shoqëruar me mister. "Gazeta Shqiptare" ka arritur të sigurojë ekskluzivisht një bisedë audio që është zhvilluar mes tezes së viktimës dhe djalit që pretendohet se ka ikur bashkë me Anxhelën në Itali, që thuhet se ishte i dashuri i saj. Në bisedën në fjalë dëgjojmë se si tezja e Anxhelës i kërkon llogari djalit (nuk bëhet me dije identiteti), pasi pretendon se ai është i vetmi që di të vërtetën e asaj që ka ndodhur. Teksa ngre gishtin akuzues ndaj tij, tezja pyet të riun për lëvizjet e fundit që kishte bërë çifti, mbi arsyet se pse kishin lëvizur në Torino apo dhe nëse kishin marrë ndonjë kërcënim. Ndërkohë, po gjatë kësaj bisede kuptohet se Anxhela ishte martuar në Itali me një të moshuar (nga biseda thuhet 100 vjeç), për efekt dokumentesh. Nga ana tjetër, djali mohon kategorikisht që të ketë lidhje me ngjarjen në fjalë, ndërsa tregon se gjithçka i kishte ardhur papritur.

BISEDA

Tezja: Me kë e kishte kërkesën? Ikët nga një qytet në një qytet tjetër. Se di pse u bë kjo ikja...
Djali: Shkuam për të

gjetur punë.

Tezja: Jo se kishte Anxhela apo ti ndonjë...
Djali: Kishim 7 ditë. Më dëgjon. Kishim 7 ditë që kishim shkruar atje.

Tezja: 7 ditë, jo më shumë?
Djali: Jo. Aq kishim.

Tezja: Unë s'di asgjë. Mua më thoshte Anxhela që ne... Anxhela me kë kishte kërkesë, se nuk e vranë për një suflaçe, e hoqën nga faqja e dheut dhe e hodhën si një qen në rrugë. Ti që ke një vit e gjysmë e di shumë mirë se kush e vrau Anxhelën.

Djali: Dëgjo, kërcënime s'ka pasur as ajo, as unë. S'e imaginoj dhe s'e kuptoj dot se kush ka qenë.

Tezja: S'e imaginoj dot ti ehhh.

Djali: Jo s'e imaginoj dot. Se do shkoja ta kapja atë njeri, le të vdisja edhe unë.

Tezja: S'të ka bërë ankesë për asnjë lloj gjëje. Kjo ishte 'bam bam'!

Djali: Jo, s'më ka bërë asnjë ankesë. Biles këtë gjëra që të thashë ty, ia kam thënë edhe policisë.

Tezja: Është logjike që do mbash këtë linjë dhe s'do thuash një gjë tjetër tek unë.

Tezja: Më dëgjon... unë të thash. Unë s'e di... jam shumë keq. Thash të më vrisnin mua sesa atë. Është një gjë që unë



Djali: Kjo është e vërtetë. S'kam ç'a mbaj të fshehtë. Unë s'kam ndenjur... tani ti më thua këto gjëra. Po më fut mua të menjdoj keq.

Tezja: Kush, unë po të fus?!
Djali: Jo tani më bën keq edhe mua.

Tezja: Dëgjo për shpirt të dy fëmijëve, ndoshta të ka llaforur, unë Anxhelën e kam si fëmijën time. Mua s'më vete mendja tek asnjë tjetër gjallë në botë. Vetëm ti je ai që e njëh dhe tek ty do drejtohem. Do gjykoresh vetëm ti... nuk e di. Zoti...
Djali: Më dëgjon... unë të thash. Unë s'e di... jam shumë keq. Thash të më vrisnin mua sesa atë. Është një gjë që unë

s'e prisja kurrë këtë.

Tezja: Anxhela punonte?

Djali: Jo.

Tezja: As natën, 7 ditë ditën?

Djali: As natën, as ditën.

Tezja: Anxhela ka dalë në rrugë? Më fal që po bëj këto pyetje, por kështu janë të dhënat...

Djali: Jo.

Tezja: Anxhela ka dalë natën ka punuar si prostitutë? Ma thuaj nuk më trazon kjo gjë?

Djali: Nuk është e vërtetë. Shkruhen budallallëqe në internet dhe gazeta.

Tezja: Këto i shkruajnë gazetarët italianë...

Djali: E di, sepse i kam lexuar vetë ato.

Tezja: Ashtu de... Çupa bëri celebrim me ty apo me italianin që ishte 100 vjeç?

Djali: Bëri celebrim me italian për dokumente...

Tezja: Jo me ty?

Djali: Jo, jo me mua... Pse s'të tha ty?

Tezja: S'e di ç'a të tha ty, mua më tha se kishte bërë celebrim me...

dhe nuk kishte asgjë.

Cili është apeli juaj?

Unë kërkoj drejtësi. Ajo duhet të nxjerrë gjithçka në pah. Nuk vë dot gisht nëse është ky apo ai që më vrau dritën e syve, pasi nuk e di.

gua drejt Italisë?

Ajo iku me dëshirën e saj drejt Italisë. S'e ka imponuar askush.

Gjatë kohës që ishte në Itali, keni komunikuar me Anxhelën?

Po kemi komunikuar me të. Ajo fliste me të motrën, me mua, me vëllanë. Fliste normal si gjithmonë.

Nuk të është ankuar për ndonjë problem?

Jo, jo, nuk më është

ankuar. Kishim kontakte në telefon. Vajza një ditë para ngjarjes foli me neve, se na erdhën ca plaçka nga kumata (tezja e saj) nga Greqia dhe më tha të shkoi t'i marr. Më tha që ishte shumë mirë

Del autopsia e 20-vjeçares, mjekët: S'ishte dhunuar para se të hidhej nga makina

ITALI - Detaje të reja janë publikuar mbi rastin e vdekjes së 20-vjeçares nga Fieri, Anxhela Meçani, tri ditë më parë në Itali. Sipas autopsisë së kryer nga mjeku italian Roberto Testi, caktuar nga prokurorët publikë Anna Maria Loreto dhe Livia Loçi, të cilët po hetojnë lidhur me rastin e shqiptares, ka rezultuar se ajo nuk është dhunuar para se të hidhej nga makina, shkruan "Torinotoday". Ndërkohë, lidhur me këtë ngjarje po hetojnë dy prokurorë, por deri më tani nuk ka të dhëna për ndonjë person konkret të dyshuar për vrasjen e së resë. Anxhela Meçani humbi jetën mbremënj e së dielës në spitalin Moncalieri, pasi u transportua në gjendje të rëndë, nga plagët e shumta që kishte marrë pasi u hodh nga makina. Mediat italiane shkruajnë se ajo punonte si prostitutë në shtetin fqinj, ndërkohë që ende nuk është zbardhur sesi ka ndodhur ngjarja.

Shëndetësi

Uji i detit është i pasur me antibiotikë natyralë prandaj është më pak rreziku i infeksioneve të ndryshme, por në bregdetin e mbipopulluar ose të pistë bëhet burim infeksionesh që prekin të gjitha moshat, por më shumë fëmijët dhe të moshuarit. **Rreziku më i madh që shkaktojnë jo vetëm infeksione në sy, por edhe në lëkurë janë pishinat.**



Mjeku popullor: Patologjitë që mund t'ju prekin në stinën e verës, kujdes nga pishinat

Voltiza Duro

YLLI MERJA: Si të kuroni infeksionet e syve me çajin bimor

"Ja cilët janë përbërësit e recetës së mrekullueshme"

Në periudhën e verës fillojnë patologji të ndryshme pasi me rritjen e temperaturave, rriten edhe bakteret në ajër dhe tokë. Këto e shumë faktorë të tjerë ndikojnë në dëmtimin e shikimit nëse nuk kujdesemi për sytë në mënyrën e duhur. Rrezet e diellit dëmtojnë shikimin, rrezet UVA dëmtojnë kornenë e syrit, dhe arrijnë deri në thellësi, ndërsa rrezet UVB dëmtojnë sipërfaqen e syrit. Në verë patologjitë që prekin sytë janë alergjia, infeksionet, tharja e lëngut të syve nga i nxehti ose nga përdorimi i freskueseve, kondicionerit. Gjatë sezonit të verës ka shumë ambiente që mund të merren infeksionet në sy si uji i detit i ndotur, pishina, ajri në ambiente të mbyllura si transporti publik. Uji i detit është i pasur me antibiotikë natyralë prandaj është më pak rreziku i infeksioneve të ndryshme, por në bregdetin e mbipopulluar ose të pistë bëhet burim infeksionesh që prekin të gjitha moshat, por më shumë fëmijët dhe të moshuarit. Rreziku më i madh që shkaktojnë jo vetëm infeksione në sy, por edhe në lëkurë janë pishinat. Uji i pishinave qëndron i palëvizur dhe në një sipërfaqe të vogël lahen individë të ndryshëm ku secili ka baktere të ndryshme në lëkurë, apo infeksione. Shumë njerëz mendojnë se nuk janë aq të rrezikshme pasi jo të gjithë i kapin infeksionet apo myku i pishinës. Është e vërtetë që jo të gjithë preken, pasi disa individë janë imunë ndaj disa baktereve, sepse kanë sistem imunitar më të fuqishëm, ose sepse trupi i tyre ka kaluar një infeksion të tillë në moshë më të re dhe ka krijuar antitrupa mbrojtës, të cilët lëvizin në gjakun e tij dhe e mbrojnë përgjatë gjithë jetës. Infeksionet e syrit janë dy llojesh: infeksion i kapakut të syrit ose i të bardhës së syrit. Këto infeksione ndo-



Mjeku popullor
Ylli Merja

dhin për shkak të ndotjes së ajrit, thatësisë dhe mungesës së higjienës personale. Duhet evituar në maksimum prekja e syve gjatë gjithë kohës, duart janë të mbushura me mikrobe edhe pse lahen shumë herë, sidomos në ambiente publike, autobus, dyqane, supermarkete etj. Kopshtet dhe çerdhet duhet të rritin higjienën gjatë periudhës së verës pasi fëmijët janë të parët që preken nga infeksionet, dhe kopshtet janë vendet ku përhapen mikrobet, bakteret dhe parazitët shumë shpejt. Alergjia në verë prek njerëzit që janë alergjikë nga pluhuri ose poleni, e kjo ndodh më shumë në periudhën e fillimit të verës. Pluhuri dhe poleni shpërndahen me anë të erës. Alergjia shkakton fryr-

je të syve, kruajtje dhe skuqje. Sinoziti është një sëmundje tjetër që në periudhën e verës është më e shpeshtë, pasi nga rritja e temperaturës shkakton acarimin e infeksionit që sjell sinozitin. Kjo jep rëndesë dhe dhimbje në pjesën e syve dhe ballit, sidomos gjatë qëndrimit në diell. Për individët që vuajnë nga sinoziti këshillohet të përdorni syze dhe të mos qëndrojnë në diell për një kohë të gjatë. Nëse keni irritim të syve, skuqje e fryrje të tyre në pjesën e poshtme mund të keni mungesë lëngu në sy. Në rastin e infeksioneve të kapakut të syve mund të formohen kokorra të vogla në këtë zonë.

KËSHILLA PRAKTIKE

Në periudhën e verës du-

sur higjienë maksimale nëse përdorni lente. Këshillohet të përdorni ushqime që përmbajnë beta karoten si karota e të mbani syze në pishinë ose det. Kujdesuni që të përdorni furça të lara për përdorim afër syve, por edhe për fytyrën. Kur shkon tek parukierja sigurohuni që të jetë duke përdorur peshqirë dhe furça të pastra.

TRAJTIMI ME BIMË MEDICINALE

Kamomili përmban terpenë, kumarin dhe flavonoide e të gjitha këto i japin veti antioksidante, antibakteriale dhe antiinflamatore. Prandaj kamomili është qetësues i mirë i inflamacioneve në sy, dhe largon kështu infeksionet e syve. Kokoceli përmban flavonoide, polifenole dhe acide karboksilike që i japin veti antibakteriale, asprigjente, dhe antiinflamatore. Kokoceli dhe kamo-

mili janë dy bimë, të cilat eksperimentalisht kanë vepruar kundër infeksioneve të syrit që janë përdorur që në lashtësi, por përdorimi i tyre vazhdon akoma edhe sot.

Përgatitja e çajit bëhet kështu: Në një gotë ujë të valuar hidhni 1 lugë gjelle me kamomil dhe 1 lugë gjelle me kokoceli. Lihet të qëndrojë i mbuluar për 3-5 minuta dhe më tej kullohet çaji. Merrret një fasho, laget me çajin dhe vendosen kompresat te sytë. Kjo përsëritet 2 herë në ditë, mëngjes e darkë. Gjithashtu, çaji i boronicës së zezë duhet përdorur në të njëjtën kohë. Boronica është ndër bimët më të fuqishme që rigjeneron nervin e shikimit dhe rregullon qarkullimin e gjakut në tru. Çaji i boronicës duhet përdorur tri herë në ditë nga një gotë.



Nikollaj: Në datë 18, takim me përfaqësues të ministrisë

Minatorët: Do të vazhdojmë protestën deri në miratimin e statusit

Rreth 300 minatorë në pension protestuan ditën e djeshme para Kryeministrit, ashtu siç kishin paralajmëruar një javë më parë. Me pankarta në duar, ata premtuan se nuk do të largohen nga sheshi deri në miratimin e statusit të minatorit. Në një prononcim për "Gazeta Shqiptare", kreu i sindikatës së minatorëve, Fiqiri Xibri thotë se deri më tani ende nuk kanë marrë asnjë reagim nga instancat përkatëse, pavarësisht protestave të shumta nga kjo kategori. "Deri më tani nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga ministria e qeveria, asnjë! Ata dalin fla-

JEMI PA PËRGJIGJE
"Deri më tani nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga ministria e qeveria, asnjë! Ata dalin flasin me vete në televizor dhe ne po ashtu. Nesër (sot) do të protestojmë sërish e do të vendosim se çfarë do të bëjmë më tej", - theksoi Xibri.



Dje gjatë protestës së minatorëve

TAKIMI PËR STATUSIN
"Ne po presim takimin e datës 18-të të këtij muaji, ku do të vendosim në lidhje me miratimin e statusit së bashku me përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë e Financave. Do të këmbëngulim e nuk do të heqim dorë deri në miratimin e statusit të minatorit e plotësimin e kërkesave të kësaj kategorie", - nënvizoi Nikollaj.



sin me vete në televizor dhe ne do të protestojmë sërish e do të vendosim se çfarë do të bëjmë më tej", - theksoi Xibri. Ndërkohë, kreu i Konfederatës së



Sindikatave të Shqipërisë, Kol Nikollaj tregon për 'GSH' se në datën 18 do të ketë një takim mes përfaqësuesve të dy sindikatave dhe atyre të Ministrisë së Ekonomisë e Financave. "Ne po presim takimin e datës 18-të të këtij muaji, ku do të vendosim në lidhje me

miratimin e statusit së bashku me përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë e Financave. Do të këmbëngulim e nuk do të heqim dorë deri në miratimin e statusit të minatorit e plotësimin e kërkesave të kësaj kategorie", - nënvizoi Nikollaj.vo.du

Voltiza Duro

Boçi: Ministria, përgjegjëse për degradimin e maturës. MASR: Prokuroria të fillojë hetimet

Maturantët i nënshtrohen provimit të matematikës, del teza gjatë testimit

Xhemollari: Kishte internet e valë nëpër klasa

Ditën e djeshme rreth 37 mijë maturantë në mbarë vendin iu nënshtroan testimit të tretë të detyruar të Maturës Shtetërore, atij të matematikës. Por ashtu, siç ndodhi edhe në provimin e Gjuhës Letërsisë, gjatë momentit që nxënësit po testoheshin, u publikua në rrjetet sociale teza e provimit. Denoncimi u krye nga deputeti i PD-së, njëkohësisht anëtar i Komisionit të Medias dhe Edukimit, Luçiano Boçi si dhe drejtori ekzekutiv i organizatës rinore "Qëndresa Qytetare", Rigels Xhemollari. "Ky lajm është më se i vërtetë, pasi u konfirmua edhe nga maturantët të tjerë, nëpërmjet një aplikacioni që ne kemi vënë në dispozicion të maturantëve. Na erdhën tezat me foto, sapo filloi provimi. Ky rast duhet të vërtetohet nga Ministria e Arsimit, e cila duhet të bëjë përgjegjës për këtë. Ne arritëm të vërtetonim faktin që teza u shpërnda, internet kishte, valë kishte, por nuk kemi informacion mbi burimin nga u bë denoncimi. Kjo duhet vërtetuar nga ministria", - tha për "Gazeta Shqiptare", Rigels Xhemollari. Ndërkaq, pak pas këtij denoncimi vetë MASR ka reaguar në një deklaratë për mediat ku ka kërkuar nga prokuroria që të fillojë hetimin e menjëhershëm të dy rasteve të bëra publike 'online'. "MASR garanton publikun se ka marrë çdo masë që parashikon ligji për të garantuar fshehtësinë dhe integritetin e testeve të maturës në fazën e hartimit dhe shpërndarjes në 38 DAR dhe ZA, 206 mjediset ku zhvillohet provimi për 37 mijë maturantë, të cilët mbikëqyren nga rreth 4300 administratorë dhe monitorues. Për këtë arsye, i kërkojmë organit të prokurorisë të fillojë hetimin e menjëhershëm të dy rasteve të bëra publike 'online', duke mundësuar

PROVIMI
"Do e klasifikoja testimin e sotëm (djeshëm) si të nivelit mesatar apo poshtë tji. U druhesha gjithmonë kërkesave të vështira, por nuk rezultuan plotësisht të tilla. Me hamendësim, ndoshta jo në notën maksimale, por e mundshme të marr rezultatin 9 ose 8", - thotë për 'GSH' një tjetër maturant.



vënien përballë ligjit të shkëlqes, kushdo qofshin ata", - theksohet në deklaratën e MASR. Ndërkohë, deputeti i PD-së, Luçiano Boçi është shprehur se është vetë ministria përgjegjëse që maturantët është degraduar në një mall 'online'. "Ministria mban përgjegjësi të plotë ligjore që testi u fotografua në sallë dhe u shpërnda nëpërmjet telefonit, të ndaluar sipas ligjit. Ministria e di mirë se është ajo përgjegjëse që ka degraduar maturantët në mall 'online' dhe ka shkelur me këmbë punën disavejçare të nxënësve e prindërve", - shprehet Boçi.

TESTIMI
Ditën e djeshme, "Gazeta Shqiptare" ka qenë e pranishme në gjimnazin "Sami Frashëri" dhe "Ismail Qemali" në kryeqytet. Maturantët, të pyetur pas testimit janë

"TEZA U SHPËRNDË"
"Na erdhën tezat me foto sapo filloi provimi. Ky rast duhet të vërtetohet nga Ministria e Arsimit, e cila duhet të bëjë përgjegjës për këtë administratorët. Ne arritëm të vërtetonim faktin që teza u shpërnda, internet kishte, valë kishte", - tha për "Gazeta Shqiptare", Rigels Xhemollari.



MINISTRJA, PËRGJEGJËSE
"Ministria mban përgjegjësi të plotë ligjore që testi u fotografua në sallë dhe u shpërnda nëpërmjet telefonit, të ndaluar sipas ligjit. Ministria e di mirë se është ajo përgjegjëse që ka degraduar maturantët në mall 'online' dhe ka shkelur me këmbë punën disavejçare të nxënësve e prindërve", - shprehet Boçi.



shprehur se teza nuk ishte shumë e vështirë. "Provimi nuk ishte shumë i vështirë. Tipat e ushtrimeve ishin punuar gjatë orëve të mësim-it dhe orëve të konsultimeve", - tha për 'GSH' një prej maturanteve të "Qemal Stafa". Edhe një prej

nxënësve të Sami Frashërit e ka konsideruar testimin e matematikës në nivelin mesatar, pavarësisht se u druheja përyetjete të vështira. "Duke dhënë përvojën personale, si nxënësi me më shumë prirje në lëndët shoqërore, do e klasifikoj testimin e sotëm si të

nivelit mesatar apo poshtë tji. U druhesha gjithmonë kërkesave të vështira, por nuk rezultuan plotësisht të tilla. Me hamendësim, ndoshta jo në notën maksimale, por e mundshme të marr rezultatin 9 ose 8", - thotë për 'GSH' një tjetër maturant.

TAKIMI

Investimet me BERZH, dyfishim kapacitetit të Bovillës

Tirana do të ketë gati paketën e dytë të investimeve për zgjerimin e rrjetit të ri të ujësjellës-kanalizimeve në zona, të cilat vitet e fundit kanë njohur zhvillim të madh. Lajmin e dha kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, pas vizitës nëditore në Stokholm të Suedisë, ku mori pjesë në konferencën e organizuar nga BERZH-i me investitorë të ndryshëm, për të diskutuar financimin e një sërë projektesh të ndërsimimeve për kryeqytetin. Në konferencë, Bashkia e Tiranës paraqiti propozime konkrete për garantimin e furnizimit me ujë të pijshëm 24 orë në ditë të qytetit. "Kemi nisur fazën e parë të investimeve me BERZH-in, që përkthehet në dyfishim të kapacitetit të Bovillës, si edhe vendosjen e linjave të transportimit nga Bovilla drejt Astirit, Unazës së Re, që kanë qenë zonat më problematike të Tiranës, kryesisht të furnizuara me ujë pusi, por që tani janë rritur tej mase në popullsi. Jemi gati të propozojmë një paketë të dytë për UKT-në. Ambicia jonë është që brenda 5 viteve nga fillimi i këtyre investimeve, të kemi ujë 24 orë në Tiranë", deklaroi Veliaj. Ai më tej tha se donëse nuk janë rritur taksat për familjarët, falë rritjes së performancës financiare, Bashkia e Tiranës është një nga subjektet ideale për t'u financuar nga BERZH-i dhe shumë prej institucioneve që financojnë projekte të tilla.

SHKURT

Statistikat financiare, Sejko: Duhet të ndjehin zhvillimin e tregjeve

Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Bankën Qendrore Evropiane organizuan të mërkurën në Tiranë një seminarin rajonal në fushën e statistikave të bankës qendrore. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, tha se kriza financiare ka rritur presionin për të siguruar statistika më cilësore dhe të besueshme. Sipas tij, zhvillimi i shpejtë i tregjeve financiare kërkon që statistikave të ecin me të njëjtin hap. Guvernatori Sejko theksoi se analizat e bankave qendrore po mbështeten gjithnjë e më shumë të modelet komplekse, të cilat mundësojnë analizën e njëkohshme të ekonomisë reale, tregjeve financiare dhe ndërlidhjeve me partnerët e huaj. Për këtë arsye, cilësia dhe besueshmëria e informacionit statistikor ka rëndësi të veçantë. Prej një viti, Shqipëria zbaton Sistemin e Përmirësuar të Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshme të FMN-së dhe është angazhuar në përbushjen e disa kërkesave të rrepta për prodhimin, shpërndarjen dhe dokumentimin e të dhënave statistikore. Ky proces ka sjellë një përmirësim dhe pasurim të ndjeshëm në statistikat zyrtare të prodhuara nga Instituti i Statistikave, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave.

Sezoni turistik, Tatimet: Shtëpi me qira, pronari do paguajë 15% të të ardhurave

Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve ka njoftuar të gjithë individët që shfrytëzojnë shtëpitë apo apartamente për t'i dhënë me qira, të deklarojnë të ardhurat e përfituara prej tyre. Përfituesi i të ardhurave (pronari i shtëpisë dhe apartamentit) është i detyruar që të paguajë tatim në burim në masën 15% të të ardhurave. Në njoftimin e DPT-së thuhet se individët duhet të regjistrohen paraprakisht në drejtorinë rajonale përkatëse dhe të paguajnë tatimin jo më vonë se data 20 e muajit të ardhshëm. "Për një ecuri sa më pozitive të sezonit turistik, Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve, në kuadër edhe të masave që po zbaton, dëshiron t'i u bëjë me dije të gjithë atyre individëve, të cilët zotërojnë asete të tilla, si shtëpi apo apartamente dhe i ofrojnë me qira, të shfrytëzojnë të drejtën për të përfutur të ardhura të ligjshme. Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve, ju kujton, se në zbatim të ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" neni 8 dhe 9, këto të ardhura janë të tatueshme me shkallë tatimore 15%", thuhet në njoftim.

Ornela Manjani

Agjencia çel procedurat për pranimin e aplikimeve, gjashtë dokumentet

ATP: 2000 pronarët që marrin 2 miliardë lekë

Përfituesit në Durrës, Tiranë, Korçë, Fier, Vlorë, Shkodër

Rreth 2 mijë pronarë, që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje, do të marrin brenda pak ditësh kompensimin. Përfituesit janë në qarkun Elbasan, Berat, Durrës, Tiranë, Korçë, Fier, Vlorë, Shkodër, Gjirokastrë dhe qarkun Dibër. Masa e kompensimit financiar për pronarët e pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e legalizuara arrin në rreth 2 miliardë lekë.

APLIKIMI

Agjencia e Trajtitimit të Pronave çel në datën 18 qershor procesin për pranimin e kërkesave për kompensimin e pronave që iu është zënë toka nga ndërtimet pa leje. "Agjencia e Trajtitimit të Pronave njofton fillimin e procesit të pranimit të kërkesave për kompensimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet informale, gjeneralitetet dhe të dhënat e të cilëve janë sipas VKM Nr.291, datë 21.05.2018, VKM. Procesi i pranimit të kërkesave të subjekteve përfituesve do të fillojë në datën

18/06/2018 dhe nuk do të jetë i kushtëzuar dhe i kufizuar në kohë. ATP fton të gjithë subjektet e interesuara, të paraqiten pranë zyrave të saj, në adresën Rruga "Muhamet Gjollësia", Nr. 54, Tiranë, çdo ditë nga e hëna në të premte, për plotësimin e kërkesës për kompensim dhe dorëzimin e dokumenteve përkatëse"-thuhet në njoftimin e Agjencisë. Sipas ATP-së subjekti kërkues (subjekti përfutur/trashëgimtari ligjor/përfaqësuesi me prokurorë), në momentin e plotësimit të kërkesës për kompensim, duhet të paraqesë: kërkesën për kompensimin e pronës, dëshminë e trashëgimit për të

gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfutur/prokurorë e posaçme, të nënshkruar nga të gjithë subjektet që përfitojnë kompensim, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare, në emër të tyre, vërtetimin origjinal të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfutur, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare (IBAN), ku do të transferohet vlera financiare e përfutur; fotokopjen e dokumentit të identifikimit dhe mandat pagesën, që vërteton pagimin e tarifës së shërbimit.

GJASHTË DOKUMENTET

- 1.Kërkesën për kompensimin e pronës, sipas formatit tip, që i vihet në dispozicion nga ATP;
- 2.Dëshminë e trashëgimit për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfutur, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil;
- 3.Prokurorë e posaçme, të nënshkruar nga të gjithë subjektet që përfitojnë kompensim, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare, në emër të tyre. (Në rastet kur nuk është e mundur të dorëzohet prokurora e posaçme, secili bashkëpronar apo një pjesë e tyre, paraqesin kërkesë individuale apo të përbashkët, për pjesën takuese në pronën që kompensohet. Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të një pjesë të tyre, për çdo kërkesë të kryer, paguhet tarifë shërbimi në vlerën 2 000 (dymijë) lekë, pavarësisht se i përket të njëjtit pasuri të paluajtshme);
- 4.Vërtetimin origjinal të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfutur, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare (IBAN), ku do të transferohet vlera financiare e përfutur;
- 5.Fotokopjen e dokumentit të identifikimit;
- 6.Mandat pagesën, që vërteton pagimin e tarifës së shërbimit në vlerën 2 000 lekë.

Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pronave	Nr. i pasurisë	Masa e kompensi	Çmimi (leke/m ²)
10	11	12	13	14	15	16
MARSEL	ABAZ	LALA	1	213/30	151.30	479
LINDITA	SULEJMA	JONUZZLA	2	76/146	248.80	479
Astrit	Berom	Dylqeshi				
Avion	Hasan	Shima				
Edmond	Berom	Dylqeshi				
Lejla	Berom	Dylqeshi				
Luan	Hasan	Shima				
Lulzim	Besim	Kurdari				
Pranvera	Hasan	Lushi				
Zenepe	Hasan	Shima	3	5/184	42.80	23,703
ALMA		HALEBI				
BAJRAM		HALEBI				
BLENDI		VATHI				
EQEREM		VATHI				
FIQIRET		HIDI				
NAIME		VATHI				
NAZIME		VATHI				
VJOLLCA		SEFERI	4	10/274	35.60	29,106
ZANA		DEMA				
ALMA		HALEBI				
BAJRAM		HALEBI				
BLENDI		VATHI				
EQEREM		VATHI				
FIQIRET		HIDI				
NAIME		VATHI				
NAZIME		VATHI	5	10/266	33.40	29,106
VJOLLCA		SEFERI				
ZANA		PEMA				
ALMA		HALEBI				
BAJRAM		HALEBI				
BLENDI		VATHI				
EQEREM		VATHI				
FIQIRETE		HIDI				
NAIME		VATHI				
NAZIME		VATHI				
VJOLLCA		SEFERI	6	10/272	2.10	29,106
ZANA		DEMA				
EQEREM		VATHI	7	10/445	8.7	29,106
MBIVENDOSJE			8	10/439	121.3	29,106
Shoqëria Amfora Shpk			9	10/461	5.40	29,106
BAJRAM		FARUKU	10	5/488	471.30	33,755
QERIM		FARUKU				

Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pronave	Nr. i pasurisë	Masa e kompensi	Çmimi (leke/m ²)
10	11	12	13	14	15	16
AFERDITA		KONXHOL				
ARBEN	ABDYL	CANI				
ENRIETA	SELIM	VOZGA				
HAJRIE		CANI				
HAXHI		CANI				
ISHE		CANI				
MYZEJEN		MURTHI				
NADIRE		CANI	11	2/501	287.60	33,755
KASTRIOT	SEFER	BENGASI	12	11/1168	53.50	33,755
AISHE		LLAGAMI (SARAÇI)				
HYSEN		SARAÇI				
ISMETE		SARAÇI				
PELLUMB		SARAÇI	13	7/275	94.00	38,614
BURBUQ		KOKA				
FLUTUR		SKEND				
MIMOZA		KAPSH				
VJOLLCA		BASHA	14	3/122	166.00	38,614
AISHE		LLAGAMI				
HYSEN		SARAÇI				
ISMETE		SARAÇI				
PELLUM		SARAÇI	15	7/414	67.00	38,614
BEHARE		SALIAGA				
XHEVRIJE		MULLISI(S)				
LUAN		SALIAGA				
HAMIDE		SALIAGA				
FATMIR		LUZI				
TIRE		LUZI				
SHPETIM		LUZI				
LULJETA		QATIBI				
MERITA		BARDHI				
SILVANA		BELLO				
VIKTOR		SALIAGA				
ELTON		SALIAGA				
LEDION		SALIAGA	16	2/316	447.00	30,783
SELIM	ARSHI	AHMETI	17	315/202	158.80	4,242
FREDERI	SPIRO	GJERASI	18	6/1253	116.40	31,219
KLAUDJA	SULEJM	TOTO				

IBRAHIM	OSMAN	PINARI					
LINDITA	SEFER	PINARI					
NURI	XHAFAER	PINARI					
SAMIR	SEFER	PINARI					
DEMIR	OSMAN	PINARI					
GANI	XHAFAER	PINARI					
ISMAL	OSMAN	PINARI					
LULEZIME	SEFER	PINARI					
ALBAN	NURI	ALLAMANI					
ASTRIT	SELIM	FUGA					
FITNETE	XHAFAER	KUKALES					
FLORINDA	NURI	ALLUSHI					
HAMIDE	SELIM	FUGA					
REZART	NURI	ALLAMANI					
XHAVIT	SELIM	FUGA					
ALEKSAN	HAMDI	DEMA					
BASHKIM	SELIM	FUGA	66	8/285	195.40	66.969	
FUAT	SELIM	FUGA					
MERITA	HAMDI	KALE					
NAZME	HAMDI	KRIST					
VJOLLCA	HAKI	META					
FLAMUR	HAKI	PINA					
GENTIAN	HAKI	PINA					
MIMOZA	SEFER	PINA					
HAMIT	AHMET	PINA					
FATIME	XHAFAER	KETA					
FITNETE		PINA					
ANILA	HAKI	PINA					
ARBEN	HAKI	PINA					
KAJE		PINA					
ERVIN	NAZMI	PINA					
ILDA	NAZMI	PINA					
ADA	NAZMI	PINA					
EVA	NAZMI	PINA					
BRIKENA	NAZMI	HIDRI					
EVELINA	SELIM	HOTI					
XHUVANE		PINA					
BAHRI	OSMAN	PINA					
IBRAHIM	OSMAN	PINA					
SAMIR	SEFER	PINA					
FITNETE	XHAFAER	PINA					
HAMIT	AHMET	PINA					
NURI	XHAFAER	PINA					
DEMIR	OSMAN	PINA					
YMER	OSMAN	PINA					
AGRON	SEFER	PINA					
ISMAL	OSMAN	PINA					
LINDITA	SEFER	PINA					
LULEZIME	SEFER	PINA					
MIMOZA	SEFER	PINA					
FLAMUR	HAKI	PINA					
GENTIAN	HAKI	PINARI					
GANI	XHAFAER	PINARI					
VJOLLCA	HAKI	META					
ARBEN	HAKI	PINARI					
SABRI	SHAQIR	PINARI					
XHUVANE		PINARI					
ISHE	HAXHI	PINARI					
FATIME	XHAFAER	KETA					
ALEKSAN		DOMA					
FITNETE		PINARI					
ANILA	HAKI	PINARI					
SADIK	HAXHI	PINARI					
ERVIN	NAZMI	PINARI					
ILDA	NAZMI	PINARI					
ADA	NAZMI	PINARI					
EVA	NAZMI	PINARI					
BRIKENA	NAZMI	PINARI					
NAZME		DOMA					
MERITA		DOMA					
FATMIRA	HAXHI	PINARI					
KAJE		PINARI	69	8/916	120.80	66.969	
BESNIK	MASAR	SOPOTI					
FISNIK	MASAR	SOPOTI	70	8/894	1.00	66.969	
FATIME	XHAFAER	KETA					
HAMIDE	XHAFAER	KUSI					
DEMIR	OSMAN	PINARI					
AGRON	SEFER	PINARI					
BAHRI	OSMAN	PINARI					
NURI	XHAFAER	PINARI					
GANI	XHAFAER	PINARI					
LULEZIME	SEFER	PINARI					
SABRI	SHAQIR	PINARI					
SAMIR	SEFER	PINARI					
ALBAN	NURI	ALLAMANI					
ASTRIT	SELIM	FUGA					
FLORINDA	NURI	ALLUSHI					
ISMAL	OSMAN	PINARI					
LINDITA	SEFER	PINARI					
REZART	NURI	ALLAMANI					
HAMIDE	SELIM	FUGA					
HAMD	AHMET	PINARI					
MIMOZA	SEFER	PINARI					
BASHKIM	SELIM	FUGA					
FUAT	SELIM	FUGA					
ALEKSAN	HAMDI	DEMA					
NAZME	HAMDI	KRISTANI					
FITNETE	XHAFAER	KUKALES					
MERITA	HAMDI	KALEMI					
XHAVIT	SELIM	FUGA					
GENTIAN	HAKI	PINARI					
FLAMUR	HAKI	PINARI					
VJOLLCA	HAKI	META					
ARBEN	HAKI	PINARI					
IBRAHIM	OSMAN	PINARI					
YMER	OSMAN	PINARI					
SADIK	HAXHI	PINARI					
ISHE	HAXHI	PINARI					
MEDIHA	HAXHI	PINARI					
FITNETE		PINARI					
ANILA	HAKI	PINARI					
XHUVANE		PINARI					
KAJE		PINARI					
ERVIN	NAZMI	PINARI					
ILDA	NAZMI	PINARI					
ADA	NAZMI	PINARI					
BRIKENA	NAZMI	HIDRI					
EVELINA	SELIM	HOTI	71	8/284	195.70	66.969	

EVA	NAZMI	PINARI					
SADIK	HAXHI	PINARI					
ISHE	HAXHI	PINARI					
MEDIHA	HAXHI	SHIMA	72	8/687	5.70	66.969	
LUMTURI		TOPTANI	73	7/926	356.00	33.755	
AISHE		TORO					
FERIT		KERC					
HYSNI		KERC					
LUMTURI		MUCA					
QEFSERE		AGO					
SHABAN		KERC	74	1/207	45.30	33.755	
ZYBER		BELBA	75	8/988	210.00	33.755	
AIDA		FRASH					
ARDIAN		TOPTANI					
BEHUE		ALDA					
FADIL		TOPTANI					
MELEQ		FRASH					
MNYRE		TOPTANI					
NADIA		FRASH					
NIRVANA							
XHEMLE		TOPTANI	76	7/917	127.60	33.755	
EDUART	ENVER	DUSHKU	77	24/5	299.90	2.560	
AIDA	AGIM	FUGU					
IKBALE	MURAT	QOSJA					
MIRAND	AGIM	FUGU					
SHPRESA	SHABAN	QOSJA					
FATBARD	MEHMET	QOSJA	78	6/689	93.70	30.783	
FATIME	XHAFAER	KETA					
GANI	XHAFAER	PINARI					
HAMIDE	XHAFAER	KUSI					
NURI	XHAFAER	PINARI					
FIDETE	XHAFAER	KUVALES					
SABRI	XHAFAER	PINARI					
NAZMI	SHAQIR	PINARI					
DEMIR	OSMAN	PINARI					
YMER	OSMAN	PINARI					
ISMAL	OSMAN	PINARI					
IBRAHIM	OSMAN	PINARI					
BAHRI	OSMAN	PINARI					
SADIK	HAXHI	PINARI					
ISHE		PINARI					
MEDIHA		PINARI					
FATMIRA		PINARI					
HAMD		PINARI					
NAZME	HAMDI	KRISTANI					
ALEKSAN	HAMDI	DEMA					
MERITA	HAMDI	KALEMI					
XHAVIT	SELIM	FUGA					
BASHKIM	SELIM	FUGA					
FUAT	SELIM	FUGA					
HAMIDE	SELIM	FUGA					
ASTRIT	SELIM	FUGA					
EVELINA	SELIM	HOTI					
ARBEN	NURI	ALLAMANI					
FLORINDA	NURI	ALLAMANI					
REZART	NURI	ALLAMANI					
FITNETE		PINARI					
SAMIR		PINARI					
LINDITA		ALLA					
LULZIM		PINARI					
AGRON		PINARI					
MIMOZA		ILJAZI					
XHUVANE		PINARI					
VJOLLCA		META	79	6/384	93.40	30.783	
ARBEN		PINARI					
ANILA		BRAHJA					
FLAMUR		PINARI					
GENTIAN		PINARI					
PETRIT	SEFER	TUJANI	80	270/1	378.00	3.283	
PELLUMB		MUCA	81	284/7	315.00	490	
KUME	MEHMET	BALI	82	102/18	378.60	3.413	
MAIQ	ISUF	LULI	83	65/150	232.20	479	
IBRAHIM		CULLHAJ					
SULLTANE		SHIMA					
IDRIZ		CULLHAJ					
REXHEP		CULLHAJ					
LUTFI		CULLHAJ					
SHERIF		CULLHAJ					
EMINE		SHIMA					
FATIME		CULLHAJ					
SADETE		CAUSHI					
HURMA		CULLHAJ					
VAJE		CULLHAJ					
RAMAZAN		CULLHAJ					
REFIK		CULLHAJ					
GEZIM		CULLHAJ					
SERVETE		KECI					
SANUE		CULLHAJ					
ZONJI		SHKRETA					
SHPRESA		ISUFA					
FLUTURA		RAXHAJA					
KUJTIM		CULLHAJ	84	6/1004	397.00	23.703	
MIMOZA		CULLHAJ					
ASTRIT		CULLHAJ					
MRELA		CULLHAJ					
BARDHA		CULLHAJ					
HANE		CULLHAJ					
ARBEN		CULLHAJ					
ADNAN	QEVJANI		85	11/374	77.00	33.755	
ZYBER	BELBA		86	8/990	18.40	33.755	
AGIM	MUCA						
BALLKIZ	KUKA						
BASHKIM	KUKA						
FATBAR	MUCA						
FIGRET	KUKA						
FLUTUR	KUKA						
HAMID	KUKA						

ISMET		KUKA					
JEMINE		VYSHKA					
LIRUE		KUKA					
LULEZIM		MUCA					
MYSLIM		KUKA					
MYSRET		MUCA					
RESHAT		KUKA					
REXHEP		KUKA					
SABRUE		KUKA					
SADETE		MUCA					
SEIT		KUKA					
SEMHA		KUKA					
SHAJE		MARAJ					
SHPRES		MUCA					
SUZANA		MUCA					
AGRON		MJOLLI					
ANDONE		MJOLLI					
ARBEN		VYSHKA					
ARTAN		KUKA					
BEDRI		MJOLLI					
BUJAR		KUKA					
FATBAR		BYLYKBAS					
IKBALE		KUKA					
ILIR		VYSHKA					
IRAIDA		MJOLLI					
ISMAL		MJOLLI					
KUME		MJOLLI					
LULJETA		VYSHKA					
MAJLIND		MJOLLI					
MEHMET		BYLYKBAS					
MELEQE		MJOLLI					
MERITA		MJOLLI					
MUSTAF		KUKA					
OSMAN		KUKA					
OSMAN							

Ramazani: Sakrificë, solidaritet, bashkëjetesë me vuajtjen, dhembjen. Filozofi e qenies njerëzore në integrim



“Gëzuar, kombi ynë, muajin e bekuar Ramadan!”, program mbarëkombëtar, i iniciuar dhe mbështetur në vite nga Kryegjyshi Botëror, Shenjtëria e Tij H. Dede Edmond Brahimaj

Prej vitesh, në të gjitha trevat e kombit tonë, realizohet programi mbarëkombëtar “Gëzuar kombi ynë muajin e bekuar Ramadan!”, - program ky i iniciuar dhe mbështetur prej vitesh nga Kryegjyshi Botëror, Shenjtëria e Tij, H. Dede Edmond Brahimaj.

Ramazani, ngjarje e shënuar, ngjarje e qindra miliona njerëzve, në të gjithë botën si dhe në të gjithë trevat e kombit tonë u prit, përjetua dhe u përcoll si ngjarja më sublimë e jetës.

Në Kuran, librin e shenjtë thuhet: “Ju krijova dhe ju ndava në fise dhe në popuj që të jetoni bashkërisht”.

Për të qenë, të bashkuar, më të afert të gjithë bashkëmbësit tanë, Kryegjyshi Botëror, Shenjtëria e Tij H. Dede Edmond Brahimaj, inicicion dhe mbështet prej vitesh këtë program të realizuar në të gjitha trevat e kombit: Kosovë; Prizren, Prishtinë, Maqedoni; Manastir, Shkup, Tetovë, Mal i Zi; Ulqin, Rrëshajë, Shqipëri; Berat, Gjirokastrë, Tiranë, Durrës etj., për të parë dhe përcjellë sesi bashkëmbësit tanë e priten, përjetuan dhe përcollën, këtë muaj të bekuar të shenjtë të Ramazanit.

Ideja dhe përshtjellimi i gjithë programeve të këtij muaji duhej të përcillej dhe gërshtëhohej me historinë e besimit, të islamit, të cilin kombi e ka parë gjithnjë si bashkim, si unitet, si identitet të tij. Skenografia e bisedave shpalosej më mirë në konturet e trevave me traditë historike, adhetare, kulturore, siç përmendim më lartë, ku siç dihet, Islami në kohë, ka luajtur një rol të madh; në idealizimin e vlerave të mëdha, ka bashkëjetuar me kohët dhe i është bashkëjetuar historisë së kombit. Edhe në momentet më të vështira të ekzistencës të tij, kur vihej në pikëpyetje qenia e tij, gjithmonë besimi cilido qoftë ai (islam dhe i krishterë), i bashkoi dhe i udhëhoqi ata për të ruajtur kombin dhe vatanin. Sot, besimi, islami jetues në konturet e globalizimit, në suazën e zhvillimeve të gjithanshme shkencore përcjell, sot ashtu si dje, vlera të një bashkëjetese brenda kontureve të perëndimit në të cilën ndodhet dhe jeton kombi ynë.

Bisedat e programeve për këtë muaj të shenjtë të bekuar përcollën dhe vijëzuan idenë dhe sfondin ku solidariteti bashkëjeton me vuajtjen, dhembjen, me më të varfërin, më të vuajturin, më të skamurin, më të pafatin, me më të lënë në harresë.

Njeriu, si qenie njerëzore, këtë muaj, ndryshon, rritet. Në këtë universitet, gjeneracioni i ndërgjegjes lartësohet, devotshmëria shkon drejt absolutizimit, si një qenie jo vetëm individuale, por edhe shoqërore. Në këtë muaj, njeriu gjendet më pranë krijesit të gjithësisë, shoqërisë, me vlera dhe



Kryetari i KMSH, Hirsësia e Tij e Naltë H. Skënder Bruçaj dhe Kryegjyshi Botëror, Shenjtëria e Tij H. Dede Edmond Brahimaj. Gjithmonë bashkë



Myftiu i madh i Kosovës, H. Naim Ternava. Besimi të Zoti adhurim për kombin



Myftiu i Tetovës, prof. dr. Haxhi Qani Nesimi. Tetova, shqiptari që njësoi besimin me kombin



Dekani i Fakultetit të Shkencave Islame në Universitetin e Shkupit, prof. dr. Shaban Sulejmani. Besimi dhe dija, emancipim i shoqërisë



Drejtori i Medresesë, Haxhi M. Dashi, H. Ali Zajmi dhe Imami i xhamisë, H. E. Tem Beu, petagogu Anton Karaj. Me dije dhe arsimin njeriu integrohet në shoqëri

vizione jo vetëm për jetën e tij, por për të gjithë njerëzit, për gjithë kombin. Deviza e qenies njerëzore, në këtë muaj është më pranë se kurdoherë tjetër ekzistencës hyjnore dhe të qenies së tij si krijesë në tokë.

Në kohë të ndryshme, edhe kur ekzistenca e kombit ishte në pikëpyetje, besimi, njerëzit të mburrur nga vlerat e tij, gjithmonë shpalosën vlera që mbizotëruan në egzigjencën e besimit, në egzigjencën e kombit si identiteti i tij. Gjithmonë besimi u pa dhe ishte pjesë e përbashkët e të gjithëve. Asnjëherë besimi nuk u pa si një mjet, për t'u manipuluar dhe për të prishur ato vlera të besimit.

Në kushtet e shoqërisë të sotme, në programet e projektit “Gëzuar kombi ynë muajin e bekuar

Ramazani”, besimtarët, njerëzit, qeniet njerëzore, bëhen pjesë e pandarë e proceseve integruese me vizione që ndihmojnë procesin në zhvillim.

Besimtarët, si qenie të devotshme, të cilët jetojnë në kohët post-moderne, përballen me to, me sfidat e globalizimit, me zhvillimet e gjithanshme të shkencave të sotme, të cilat kërkojnë ta largojnë gjithnjë e më shumë, besimin, nga aspiratat hyjnore. Është ky besim i gatuar, që u dialogua në programet e këtij muaji, që edhe pse vërbulla e globalizimit kërkon të prishë këto ekuilibra edhe sot, gjithmonë ato janë sfiduese edhe për këto kohë.

Modernizmi i kohëve të sotme nxit për besimtarin, njeriun, qenien njerëzore, egoizmin, shpirtin individualist, materializimin dhe instinktet vetjake të njerëzve. Në kundërshtim me shoqërinë dhe besimin, kërkon t'i largojë njerëzit, nga gjithçka, që ata të mbajnë të shenjtë, humane dhe etike, nga dashuria, përkujdesja, përkushtimi dhe vetësakrifica.

Në këtë muaj bëhet luftë që besimtarin, njeriun të mos jetojë me instinktet egoiste. Një njeri i tillë, që jeton me të, është jo i devotshëm, nuk ka kurrfarë besimi, te ai nuk mbizotërojnë vlerat e besimit, ndaj Krijuesit.

Kohëncën kozmike e kohëve të sotme kërkon ta bëjë qenien njerëzore robër të këtyre instinkteve, ndaj ky muaj ofron pa mbarim një dashuri dhe adhurim të veçantë, për krijuesin që ai të jetë sa më i devotshëm. Muaj i Ramazanit, që përjetuam këto ditë dhe përcollëm, nëpërmjet filmimeve të programeve tona në të gjithë trevat e kombit vjen si një shpëtim për qenien njerëzore, duke pasur në themel të tij, dashurinë dhe egzigjencën e pastër të tij, ndaj Krijuesit të gjithësisë. Në këtë muaj, lind dhe gatuhet, një forcë shpirtërore, që gjallon vlera morale të besimit të njeriut, të qenies njerëzore dhe bëhet pjesëmarrës i vlerave të njësura në ekzistencën e qytetërit të sotëm. Dhe pse modernizmi ofron liri të shfrenuar për realizimin e zhvillimeve të

sotme, besimi, dashuria ndaj krijuesit, përçon dhe mbart vlera për ndërtimin e një shoqërie, ku liritë dhe të drejtat e njeriut, janë të mbrojtura, të respektuara, në një shoqëri me besim, ku mundësitë e njëjta, për të gjithë, janë më shumë se një shans në një realitet ekzistues, që ofron rruga e besimit, rruga e Zotit.

Humanizmi, bashkëbisedimi ynë me lider, njerëz të shquar të doktrinës, dekanë, profesorë, shfaqet në këtë muaj, si një doktrinë e dashurisë dhe ndjenjave njerëzore. Në këtë muaj ndjehet dhe shfaqet më se asnjëherë tjetër, dhimbja për dhimbjen, vuajtja për vuajtjen, për më të varfërin, për më të pashpresin, më të lanin mënjën të kësaj bote. Solidariteti bashkëjeton me to. Në këtë muaj shfaqet më mirë se kurdoherë tjetër, prania për më të varfërin, në pasuri. Siç thuhet në shkrimet e shenjtja: tek pasuria e më të kamurit është dhe pasuria e më të varfërit. Krijuesi i gjithësisë, ashtu, siç ka vendosur dashurinë për qenien e tij njerëzore, ka vënë sprovë për të pasurin, që ai ta kuptojë se pranë tij, jeton një qenie tjetër njerëzore, një njeri që s' duhet të jetë i pangrënë. Ai si të gjithë të tjerët, duhet të jetojë në këtë jetë.

Ramazani përçon tek njerëzit që besojnë tek Zoti, se humanizmi është vullnet i dashurisë së Zotit për ta, të njerëzve për njeri-tjetrin. Vetëm kur besimi është i madh tek zoti dhe forca e besimit respektohet dhe njeri-tjetri njeriu, përsoset dhe humanizmi, bëhet pjesë e jetës së tij, e mendimit, e bōfëkuptimit, vizionit të ardhshëm humanist.

Njerëzit, besimtarët, udhëhiqen nga thënia: “Mos dëshironi për të tjerët, atë çka nuk dëshironi për veten tuaj”. Kudo, në këto ditë ringjallen ndjenjat e mëshirës në zemrat e më të kamurve, më të pasurve.

Tek njerëzit që adhurojnë dhe i luten Zotit është e gabuar të mendosh se mirëkuptimi dhe respekti, shfaqet të besimtarë të padevotshëm, ashtu siç është e gabuar, të mendosh, që virtytet bashkëjetojnë të besimtarët pa mirëkuptim, Programet e filmuara,




Petagogu Olljon Kola: Berati, qyteti 2400-vjeçar, qyteti i historisë dhe besimit

skenografuan faljen, si një mëshirë e madhe, për të gjithë. Besimtarët këto ditë i luten Zotit për t'i falur gabimet dhe mëkatet e tyre, falin, siç falin të tjerët ata. Ashtu, siç dëshirojnë të jenë të falur, dëshirojnë të falin. Një njeri, një besimtar, që nuk di të falë këto ditë, nuk mund të shpresojë të jetë i falur. Në këto ditë, vetëdija arrin përsosjen më të lartë, përmes natyrës njerëzore.

Njerëzit, besimtarët në ramazan, mësojnë, se nuk kanë të drejtë të falin ata, të cilët, falja e tyre, mund të jetë mungesë respekti për njerëzit.

Është e rëndësishme, që njerëzit ta meritojnë atë që kërkojnë.





Kryetari i KMSH Hirsësia e Tij e Naltë, H.Skender Bruçaj. Paqe dhe mirësi kudo në botë



Drejtori i KMSH, Agron Hoxha dhe dr. Genti Krupa. Shqiptarët, gjithmonë në unitet



Drejtori i Dialogut Ndërfetar i KMSH, Dorjan Demetja; Dashuria për besim është integrim



Myftiu i Ulqinit, Haxhi Efendi Ali Bardhi. Shqiptarët në vite ruajtjen besimin



Reisul Ulema Haxhi Sulejman Efendi Rexhepi, kryetar i BfI i Maqedonisë: Një komb dhe besim



Reisul Ulema Haxhi Refat Efendi Fejzić, kryetar i Bashkësisë Islame të Malit të Zi: Besimi, identiteti i kombit



Drejtori i Mardhënjeve Publike i BIK, Haxhi Ahmet Sadrija: Shqiptarët besuan të Zotit për kombin e tyre

denjë dhe i devotshëm për të qenë i besuar në adhurimin ndaj Krijuesit.

Besimtari, njeriu, qenia njerëzore, pranon të tjerët siç janë, në mendime dhe veprime të ndryshme. Gjithmonë, në realitet ekzistojnë njerëz, besimtarë që mendojnë ndryshe nga njëri-tjetri dhe kështu realiteti vazhdon të ekzistojë.

Është vlerë, virtyt, të pranosh besimtarin, tjetrin siç është.

Realiteti i sotëm i shoqërisë njerëzore bën që njerëzit të humbin disa nga tiparet ekzistenciale të jetës.

Njeriu që beson, mposht çdo gjë që ka të bëjë me humbjen e vlerave të ekzistencës njerëzore. Adhurimi në sakrificë, për ekzistencën hyjnore con në lindjen dhe ringjalljen e vlerave të reja, sesa të atyre që kërkojnë t'i humbin këto tipare dhe vlera.

Të duash tjetrin sot është ndjesia më e spikatur e një zemre në besim.

Kudo besimtari, ushqehet këto ditë nga një dashuri e veçantë, që predisponon gjithnjë e më shumë, devotshmërinë e tij, si qenie njerëzore në integrim.

zore në integrim.

Bashkëbiseduesit motivuan ecjen drejt një tolerance, që shërben si një përkushtim të asaj devotshmërie, që krijuesi kërkon për besimtarin, për njerëzit, për qenien e tyre njerëzore. Të gjithë mybillin sytë, para dobësive të të tjerëve, shfaqin respekt për idetë e ndryshme dhe falin çdo gjë që është e tolerueshme. Edhe kur përballimi me shkeljen e të drejtave tona të pa tjetërsueshme, njerëzit këto ditë, mbeten të respektueshëm, për vlerat njerëzore, përpjegin t'i zgjidhin dhe t'i venë ato në drejtësi.

Njerëzit, dashurinë dhe respektin që shfaqet në Ramazan, e ushqejnë dhe përcjellin edhe në ditët në vazhdim gjatë gjithë kohës, gjatë gjithë jetës. Ne duhet të jemi si qenie pa dyar, thotë mendimtari i shquar Gylen, kundër atyre që ju qëllojnë dhe pa fajle kundër atyre, që ju mallkojnë.

Të gjithë jemi pasardhës të Ademit, e Ademi është prej dheu. Nuk është i pranueshëm kurrfarë dallimi mes jush. Nuk ka përparësi, arabi ndaj joarabit, as joarabi ndaj arabit! I bardhi nuk është më i mirë se i ziu, as i ziu më i mirë se i bardhi. E vetmja gjë, e rëndësishme është devotshmëria personale... Jeni të mëshirshëm ndaj njëri-tjetrit. Ju jeni vëllezër e motra në mes vete. Mos mbllëzëri urrejtje, veç dashuri.

Me siguri, ata që kanë besuar, por edhe ata që janë hebrëj, të krishterë dhe abejë, që i kanë besuar Zotit dhe botës tjetër dhe kanë bërë vepra të mira, do të shpërblehen nga Zoti i tyre, për ata nuk do të ketë, as frikë, as pikëllim.

Siç thotë teologu i mirënjohur botëror, Gylen, programet tona me bashkëbiseduesit përçuan tonazën: Zoti e ka dërguar fenë, besimin për lumturinë individuale e kolektive. Feja bazohet në besimin dhe adhurimin e Zotit. Sa më e lartë të jetë shkalla e besimit të njeriut të Zoti, aq më e lartë është ndjesia e tij, ndaj qenieve të tjera. Ai kërkon që ne të jetojmë në paq.

Si rrjedhim, ajo që pritet nga besimtarët, nga ata që besojnë dhe adhurjnë vetëm Zotin, është përpjekja për paqe, vëllazëri dhe



Drejtori i kabinetit të BIM, H. Muzemil Osmani: Në Manastir, ku Zoti u thir gjithmonë shqip



Kryetari i Kuvendit të BIK, Haxhi Sinani: Në Prizren, ku besimi ishte komb



N.kryetari i KMSH, Haxhi Bujar Spahiu: Besimi të Zoti, integrim i qenies njerëzore

Dikush që nuk fal, nuk mund të ketë të drejtë të kërkojë mirëkuptim. Gjithsecili do të përballtet me mungesë respekti në atë shkallë, sa ai nuk respekton të tjerët. Ndokush që nuk do Zotin, nuk do meritotë dashurinë e tij.

Ata, të cilët nuk përqafojnë gjithçka për krijesat njerëzore, me dashuri, tolerancë dhe mirëkuptim si besimtarë, janë humbës vlerash dhe si rrjedhojë jo mikëpritës për mirëkuptim dhe falje. Është e pamundur sot të jetosh si besimtar, kur nuk punon dhe vështron të tjerët me tolerancë dhe i vetpërmëmbajtur. Një besimtar që nuk ka dhe nuk shfaq tolerancë, është e pamundur që ai të jetë i



Kryegjyshi Botëror, Shenjtëria e tij H.Dede Edmond Brahimaj: Pa atdhe, nuk ka fe

janë qytetarët e mi dhe për Allah, unë jam gjithmonë kundër çdo gjëje, që i dëshpëron ata". Asnjë lloj detyrimi nuk duhet të ketë mbi ta.

Në goftë se një femër kristiane martohet me një musliman, kjo nuk duhet të ndodhë pa aprovimin e saj. Ajo nuk duhet të ndalohet të vizitohet kishën e saj për t'u lutur. Kishat e tyre duhet të respektohen. Atyre nuk duhet t'u ndalohet riparimi i tyre, as shenjtërimi i pakteve. Asnjë njeri, nga Ummeti (bashkësia islame) nuk duhet ta shkelë këtë pakt.

Në kushtet e shoqërisë së sotme, bashkëkohore integruese, besimtarët muslimanë shqiptar janë pjesë e pandarë në proceset integruese, me vizion, që ndihmon këtë proces.

Besimtarët muslimanë dhe shqiptarë, në të gjithë trevave tona, të vetdijshëm për përgjegjësitë e tyre, thotë Kryetari i Komunitetit Musliman të Shqipërisë, Hirsësia e Tij e Naltë Haxhi Skender Bruçaj janë në kohezion me metodologjinë e interpretimit të islamit në këtë botë komplekse shqiptaro-europiane, si në aspektin gjeokulturor, e gjeo-politik, ku përkatësia definisht, është brenda perëndimit, ashtu edhe me frymën postmoderne që po bëhet mbizotëruese në botëkuptimin kulturor të shqiptarëve të sotëm.

Bisedat e programeve tona i vizionuan aspiratat dhe sfidat, si të njëjta me të gjithë ato të Europës. Jemi evropianë dhe në vorbullën social-kulturore që provokon globalizmi, një komb i vogël, si yni duhet të përshatet duke promovuar që të ruajë sa më shumë ekuilibrat e vet të brendshëm. Ne do kemi sukses, vetëm duke ruajtur ekuilibrat e brendshëm, si një komb evropian, me shumicë muslimane, ku kultivohet seriozisht harmonia fetare, e jo thjesht si një retorikë politike.

Këto vlera, këto mesazhe për-collit Ramazani, liderët e mëdhenj të kombit, besimit: "Gëzuar kombi ynë muajin e bekuar Ramazan": Myftiu i Kosovës, H.Naim Tërnavës, Reizi i Maqedonisë H. Sulejman Rexhepi, Kryetari i KMSH, H. Skender Bruçaj, Kryegjyshi Botëror, H.Dede Edmond Brahimaj, Reizi i Malit të Zi, H.Refat Fejzić, mendimtarë, dekanë, profesorë, teologë, njerëz të besimit, etj. për këtë muaj të shenjtë, të bekuar, të qindra, qindra, miliona njerëzve, në të gjithë botën dhe në trevat e kombit tonë; si një muaj që rrit, lartëson, transfiguron qenien njerëzore, botëkuptimin dhe vizionin e tij, me konture të reja më të ndritura për jetën, më largpamëse për shoqërinë, për gjithë gailidhë e madhe të kombeve si muaji i "Sakrificës, solidaritetit, bashkëjetesës me vuajtjen dhe dhembjen, fillozofi e qenies njerëzore në integrim".

Ky program mbarrëkombëtar, i inicuar dhe mbështetur, nga Kryegjyshi Botëror, Shenjtëria e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj, si një projekt që motivon si gjithnjë bashkimin dhe dashurinë e gjithë të bashkëkombësve tanë, për egzigjencën dhe dashurinë e pakuishme hyjnore, për Krijuesin e gjithësisë, në këtë muaj, Zotin e gjithëpushtetshëm, gjithëfuqishëm, gjithëmëshirshëm si një program i tillë mbarrëkombëtar, u transmetua në të gjitha kanalet televizive shtetërore dhe private në vendet ku ndodhet dhe jeton kombi ynë, në të gjithë vatrat shqiptare: RTSH-Shqipëri (vale tokësore, satelitore, platforma digjitale RTSH+), Radio Televizioni "Ora News", RTK1-Kosovë (vale tokësore, satelitore), MTV2-Maqedoni (vale tokësore, satelitore), RTV-Mali Zi, "Teuta" (vale tokësore, satelitore), "UFO" TV, Platforma Alfa Dixhitale, TV "Shijak", TV "Besa" Prizren, "One TV" Vlorë, TV "Fokus" dhe "Real" Vlorë, TV "Adriatik"-Durrës, TV "Apollon"-Fier, TV "Kombi"-Fier, RTSH Gjirokastër, TV "Lobi"-Korçë, TV "Globi" e TV Berat, TV "One Channel"- Shkodër, TV "Telefon"-Sarandë, TV "Koha" - Tetovë, TV "Art", TV Gostivar, TV Kërçovë etj.,

DEBATI PËR TEATRIN

"TEATRI? JEMI NË LUFTË"

Ndrenika: S'mund të trokas tek Aneta e t'i them dua të takoj djalin tënd

Fatmira Nikolli

Ndonëse qeveria ka nisur takimet e llogaridhënies publike nëpër rrethe, për të marrë ankesat e qytetarëve, prej katër muajsh, edhe pse në kryeqytet, aktorët që kërkojnë të mbrojnë Teatrin Kombëtar, as nuk i pret e as nuk i dëgjon njeri. Ndërsa kanë dhënë ultimatum deri të premtën për të tërhequr projektligjin që i hap rrugë shembjes së TK-së, dje, një përfaqësi e tyre shkoi në Komisionin Parlamentar të Medias për këtë çështje. Robert Ndrenika, Alfred Trebicka, Alert Çeloalija, Taulanda Jupi dhe Robert Budina gjetën një komision të braktisur nga deputetët e mazhorancës vendimarrëse. Aktorët, pjesë e Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit si fillim, lexuan një letër drejtuar presidentit, kryetarit të Kuvendit dhe institucioneve të tjera. Në të, shprehën indinjatën për projektligjin e Ministrisë së Kulturës për të shtatëruar goditën e Teatrit. "Projektligji është propozuar pa marrë në konsideratë opinionin tonë. Prezantohet në formën e një kontrate të mbyllur. Parlamenti zhvendoset nga detyra për të hartuar projektligje, kthehet në noter. Vendimi mund të krijojë një kolaps në vend. Nëse deri të premtën nuk do të kemi reagim, atëherë do të uzurpojmë godinën e Teatrit Kombëtar, si e vetmja formë që zëri jonë të dëgjohet", thanë ata në letër. Aktorët që protestojnë prej muajit shkurt, kanë bërë me dije se do ta mbrojnë teatrin me turne duke e uzurpuar atë, pas të premtës nëse qeveria nuk tërhiqet nga projekti për ta shembur dhe për të tjetërsuar një pjesë të truallit, tek privati në këmbim të ndërtimit të teatrit po nga privati.

ARTISTËT

Në fjalën e tij, Robert Budina tha se për shkak të asaj që po ndodh, ju duket se "me jetën tonë po luhet teatër, qartësisht".

Më tej, aktori Alfred Trebicka u shpreh se për të është domethënëse fakti që deputetët e mazhorancës nuk janë sot këtu. "E di që ministrja e Kulturës në plot dëgjese, nuk ka ardhur. Bëjnë takime llogaridhëse me popullin, këta që shkojnë në çdo qosh të dëgjojnë ankesa, nuk i japin fjalën Robert Ndrenikës që të dëgjojnë

Ndrenika: Qeveria s'na përfill, ndihem i përbuzur, çështja e Teatrit Kombëtar është vjedhje

Fundi i llogaridhënies publike, mazhoranca braktis komisionin ku artistët flisnin për teatrin



hallin e tij, shqetësimin e tij?" Për Trebickën, janë frikacakë e fshihen, e mbrohen nga pushteti. "Në rast se do shkohet deri te akti i shembjes së teatrit, do të jetë një turp për ata që e bënë, ne që e pranuan. Do jetë si Plenumi i Beratit në histori, një njollë e zezë".

Mandej, aktori Alert Çeloalija vuri në dukje se Shqipëria në total ka më pak teatro se vetë qyteti i Shkupit. "Nëse mungojnë paratë për të ndërtuar një teatër dinjtoz le të kërkojmë ndihmë. U paraqit një projekt, ku ca nuk u lanë të flisnin e ca nuk u lanë të hyjnë. Ai projekt nuk i sjell gjë të re Tiranës, por është edhe prapambetje", tha Çeloalija. Ai tha se kapaciteti i dy teatrove aktualë, atij Kombëtar dhe atij

Keperimental që lihet qëllimisht në harresë e nuk përmendet, sot është mbi 1030 vende. "Këta duan të shembin këta dy teatro dhe në vend të tyre të ndërtojnë një teatër me vetëm 800 vende, ku 600 ka një sallë e nga 100 dy salla të tjera".

ROBERT NDRENIKA NË KRYE

"Nuk shembet ai teatër, veç po kaluat në trupat tanë". Kjo ka qenë fraza që Ndrenika në një darkë miqësore të dy viteve më parë, i tha ministrës së Kulturës Mirela Kumbaro. Atëkohë, deklarata bëri bujë, edhe pse, në dukje asgjë nuk pritej të ndryshonte sa i takon teatrit. Dy vite më vonë, si kurrë më parë, Ndrenika është çdo të hënë në media e në teatër, në krye të

protestave, prej kur rrezik i shembjes nisi t'i kanosej godinës ku ai kaloi jetën. Për këdo që e njëj sadopak Ndrenikën, e di, që i ka zët mediat e mikrofonët, në mos është vërtet i tronditur. Kur ai vendosi të flasë, iu hoqën mikrofonët, ose u ndërpre lidhja e drejtpërdrejtë, si në mars, kur do të prezantohet projekti që po kundërshtohet prej tij dhe artistëve të tjerë.

I ndërjer i fyer, sepse ia ndaluan fjalën, Ndrenika, për atë që beson, ka dalë kundër fuqimisht e paresh-tri ndërtimit të teatrit të ri.

Dje, ai nuk ngurroi të shprehë edhe më ashpër, teksa kish marrë rrugën drejt Kuvendit, pavarësisht moshës e me gjithë vapën.

"Faleminderit që na thirrët dhe po na dëgjojnë, do të doja të ishte pala tjetër këtu, deputetët e PS. Mospjesëmarrja e tyre, bojkoti i tyre tregon se këtu duhet të fillojë lufta, jo me Korenë e Veriut, por... Nuk e kuptoj këtë gjë. Erdha me mendjen që edhe t'u flisja, edhe të hyja në debat, edhe të arsyetoja me ata, nuk di se çfarë të them. Ata nuk vijnë fare. Di t'u them që, PPP në këtë rast në veçanti, sidomos me teatrin, është shqeto vjedhje, është grabitje dhe për këtë jo unë vetëm, le të analizojnë të tërë, kjo histori ka 20 vite që ka filluar për tua dhënë privatëve, pa pyetur aktorët as opinionin publik. Arbitraritetit", tha dje Ndrenika,

për të, "me keqardhje, por këtu fillon lufta". "Mendimi ynë është ky. Nuk na dëgjon kush, na përbuzin, na braktisin. Jo vetëm neve si komunitet artistik që po na fyejnë, por edhe juve po ju poshtërojnë. Kjo është grabitje. Ka 20 vite kjo tentativë për grabitje. Ajo tokë vërtetë quhet e shtetit, por është e komunitetit teatror, kanë lënë kocka njerëzit atje. Por të vijë një fusha, a një mal apo një kodra, këtu me vete mendja se do të vjedhë edhe kryeministri, edhe ministresha, edhe kryetari i bashkisë, edhe të tërë. Duan të vjedhin të gjithë. Më vete mendja xhanëm, derisa s'na përfillin e nuk na dëgjojnë e as arsyetojnë", -tha Ndrenika dje në Komisionin e Medias.

Duke kërkuar ndjesë për tonin e gjuhën, aktori i njohur tha se "këto i kam nga mendja dhe nga shpirti njëkohësisht". "Gjatë këtyre 20 viteve si nuk u tha njëherë, që teatrin duhet ta bëjë shteti. Privati le të shkojë te Kodra e Priftit që të bëjë një teatër. Edhe shqiptarëve të Maqedonisë ua ka bërë shteti. Ne planin francez, që u paraqit para disa vitesh, nuk ekziston fare teatër, por disa kulla"- u shpreh ai.

I pyetur nga deputetja Albana Vokshi, se çfarë përpjeksh janë bërë për të komunikuar me qever-



inë dhe për të dialoguar me të, aktori Robert Ndrenika tha: "Rama nuk të përfill, ka një mendje të tij. Unë kam thënë, ç'është Meta për çështjen, dhe presidenti më thirri në takim, me kryetarin e Kuvendit po ashtu. Këto janë përpjekjet tona. Çfarë mund të bëjmë më shumë?", -pyeti ai.

Sa i takon kryeministrin, aktori shtoi se "Ai nuk të përfill, ka një mendje të tij. Unë s'mund të vete të shtëpia e Anetës, e t'i them më tako me djalin. Jo që s'më përfilli, por më hoqi mikrofonin. Ç'mesazh kam unë për të? Çfarë mundet t'i them unë Ramës? Mua më bie era grabitje. Ai studion e të atit e mori. Kjo pronë shtetërore ta marrë fusha atje. Unë nuk mund të shkoj të trokas. Ajo ministresha ka nja dy herë që i kërkoj takime e hiç. Në kemi 20 e ca vite që përdoremi në TV shqiptare. Edhe kur duan të bëjnë ndonjë shaka, këta vendosin fytyrën time, a kam të drejtë të marr ndonjë gjë", -tha aktori i njohur.

OPOZITA

Deputetja Albana Vokshi u shpreh dje në komision se çështja e teatrit dhe e tjetërsimit të pronës, e shtatërrimit të qendrës historike të qytetit, nuk i përkëtojnë parti dhe del edhe përtej artistëve prandaj është përtej axhendave. "E kemi detyrë qytetare. Kjo që po ndodh është krim historik e kulturor. Ne fizikisht dhe shpirtërisht do jemi me ju. Tani që ne flasim, Lulzim Basha, ka mbledhur një grup me juristë për të parë hapësirat ligjore. Do thërrasim përsëri e përsëri ministrin e kryetarin e bashkisë, do ndjekim me kujdes proce-

AKTORËT KUNDËR PROJEKTLIGJIT

- ▶ Pr/ligji është propozuar pa marrë në konsideratë opinionin e aktorëve.
- ▶ Pr/ligji prezantohet në formën e një kontrate të mbyllur pa konkurs me fitues të shpallur duke cenuar dhe misionin fillestar që duhet të kryejë një ligj për rregullimin e marrëdhënies në shoqëri.
- ▶ Parlamenti në këtë rast kthehet në një noter të rëndomtë që vulos kontrata dhe jep leje ndërtimi.
- ▶ Pr/ligji ad-hoc injoron tërësisht legjislacionin në fuqi që rregullon marrëdhëniet mes sektorit publik dhe atij privat, dhe del mbi ligjin.
- ▶ Injorohet pushteti privat
- ▶ Kjo sipërmarrje është atentat ndaj kulturës dhe artit në Shqipëri me rrezikun që mund të krijohet kolaps kulturor në vend duke goditur njëherazi, infrastrukturën mbështetëse që është në dispozicion të artit dhe pavarësinë statusit të aktorit, i cili konsiderohet si punëtor me mëditje.



Miliona dhe censurë, Hervin Çuli sulmon Mirush Kabashin

Aktori recitoi poezinë e Ali Asllanit kundër shembjes së teatrit dhe del kundër Çulit

Drejtori i përmend rrogat që ka marrë ndër vite duke e quajtur përfitim

Debati për godinën e Teatrit Kombëtar i ka ndarë artistët në mbrojtës dhe kundërshtarë. Nga plani i gjerë, debatet kanë kaluar edhe në planin personal.

Aktori Mirush Kabashi, gjatë një emisioni televiziv, nuk kurseu drejtorin e Teatrit Kombëtar, Hervin Çulin, të cilin e akuzoi për censurë në institucionin që ai drejton.

"Natyrisht që ka censurë. Ajo ka kaluar nga pushteti në teatër. Jemi më keq se në diktaturë. Problemi kryesor është ligji për teatrin", -tha Kabashi.

Pak orë më pas, drejtori i Teatrit Kombëtar, Hervin Çuli, përmes një postimi në rrjetin social 'Facebook', shkroi se Kabashi ka qenë 15 vjet në Teatër Kombëtar si aktor, por ka luajtur vetëm një herë.

Sipas tij, aktori Kabashi ka përfutur 10 milionë lekë në 15 vite, ndërsa e quan atë dhe mashtrues ordiner, teksa komentoi akuzën për censurë. Në statusin e tij kundër Mirush Kabashit kanë vërsuar një sërë komentesh, ku një pjesë i japin të drejtë aktorit dhe një pjesë kritikojnë drejtorin

lute", -shkroi Çuli nëpër komente. Ai vijoi se "vetë ju si publik dhe si miq të teatrit herë-herë manipuloheni nga deklamimi emocional dhe nuk dëgjoni edhe kur flasim broçkulla".

Çuli shton se "ju me dashurinë tuaj i keni mësuar që të thonë ç'të duan dhe të shpifin çfarë të duan se ata do besohen. Portalet gënjeshtërën do ta publikojnë menjëherë se e ka thënë aktori i madh dhe kështu mashtrimi i tij i ndryrë mori fuqinë e së vërtetës absolute".

POSTIMI I PLOTË:

Hahahaha! Zotëria "hani

mashtues ordiner. Më akuzoi tek emisioni i Eni Vasilit si censor të programit artistik të institucionit. Por kaq gënjeshtar ordiner është sa që shembullin e shpik aty për aty, duke ju marrë fjalë si memec, dhe ja vë në gojë regjisorit Altin Basha. Tmerr!!! Gënjën me zërin e tjetrit! Gënjeshitari ordiner thotë se unë i kam kërkuar regjisorit Basha tekstin e veprës "Gomari i Babatasit" për ta kontrolluar përpara se të jepja lejen për t'u shfaqur në skenën e TK-së".

durat", -tha Vokshi. Sipas saj, PD është pro restaurimit të teatrit dhe kundër tjetërsimit të pronës publike për afëra korruptive. "Projektligji është në kundërshtim me Kushtetutën. Teatri është pretekst për të ndërtuar kullat monstruoze", -shtoi ajo.

Në vijim, deputeti Florion Mima, kujtoi se kur ka shkuar në teatër kur ka qenë i vogël, mbante mend Ndre Nikën të ishte i ri dhe i bukur. "ka kohë që kërkohet të shembet teatri. Batakçiu që qeveris i tha atëherë Qirjaqit, 'ç'do varni në muze, brekët e Violeta Manushit'. Kjo është betejë për jetë a vdekje. Nëse nuk pranohet referendumi, do shkonim në Gjykatë Kushtetuese, por nuk ka. Gjyqtarët e tjerë janë në veting. Profesor, ju shoh të ndershëm, por përballë keni çapaçulët", ju drejtua ai Ndre Nikës.

PREZIDENTI META

Në lidhje me kërkesat e artistëve, ka reaguar presidenti Ilir Meta, ai është shprehur se në lidhje me këtë çështje duhet gjendet një dialog i përbashkët ku të mbeten të kënaqura të dyja palët.

Presidenti ka bërë thirrje qeverisë dhe bashkisë së Tiranës që të dëgjojnë artistët dhe të jenë më të vëmendshëm në kërkesat e tyre.

"Presidenti i Republikës, bën thirrje për transparencë e dialog për këtë çështje dhe i bën apel qeverisë dhe Bashkisë së Tiranës, të dëgjojnë sugjerimet dhe shqetësimet e komunitetit të artistëve e të dialogojnë në dobi të ruajtjes e promovimit të vlerave e trashëgimisë historike, kulturore e ko-

mbëtare", -shprehet Meta.

Pak kohë më parë presidenti Meta organizoi edhe një takim me një përfaqësi të artistëve për të dëgjuar shqetësimet e sugjerimet e tyre për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

TAULANT BALLA: JU PËRDORËN

Në faqen e tij zyrtare kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së dhe deputeti Taulant Balla i është përgjigjur Robert Ndre Nikës, përmes "një letre publike" ku fajin për mungesën e deputetëve të tij, ia ka hedhur, PD-së.

"I nderuar artist i madh Robert Ndre Nikë, dëgjova nga mediat se ishit ankuar për mungesën e deputetëve të grupit tim parlamentar në një mbledhje private të kryetares së Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, e thirrur në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit", - shkruan Balla.

Sipas tij, asnjë deputet i Grupit Parlamentar Socialist nuk bojkoton Kuvendin apo komisionet. "Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik e kishte përcaktuar mbledhjen e radhës më datë 18 qershor me vendim të Komisionit. Por për nevojë të skenaristit të Shqipit, që sot nuk kishte ndonjë lajm me babale, u munduan t'ju përdorin përsëri ju mish për top në teatrin e tyre të radhës. Më beso i dashur Robert, nëse Ti beson se Albana Vokshi apo Lulzim Basha e kanë me gjithë shpirt 'luftën' për Teatrin, është një lloj sikur të besosh që Lulzimi është Robert De Niro dhe Albana është Julia Roberts", -e përmbyll postimin e tij Balla.



Ky individ që mori rrogën 15 vjet dhe u ngjit në skenën e TK-së vetëm me një shfaqje, është objekt për librin e rekordeve Gines. 100 milionë lekë (të vjetër) ka përfutur me statistike në 15 vjet zotëria që fuste kartën në bankomat pa u skuqur fare.

e Teatrit Kombëtar për akuzat ndaj Kabashit.

Mes komenteve, Çuli shtoi se "e nxora në pension pas dy vitesh që paraardhësi e mbante në punë kot. Ndaj më sulmon, se donte të rrinte ende dhe të merrte rrogën qyl. Paraardhësin e tërhiqte për hunde ky kodosh, sepse ai ishte frikacak ndaj këtyre që ju i etiketoni si aktorë të mëdhenj. Dhe kështu çfarë bëni miku im? I jepni disa si ky statusin e të paprekshmit. Dhe ca si ky binden që mjafton ky status që ta hëdhin sh...ën përjetë si t'i duhet kokrra e qejfit dhe të marrin këdo që kanë inat nëpër gojë sepse ç'thonë këta është e vërteta abso-

pini dhe rrëmbeni", pasi "grabiti" për 15 vjet rrogën në Teatrin Kombëtar, ka filluar të recitojë patologjikisht mediave goja se i dhemb shpirti për godinën e Teatrit Kombëtar. Ky individ që mori rrogën 15 vjet dhe u ngjit në skenën e TK-së vetëm me një shfaqje, është objekt për librin e rekordeve Gines. 100 milionë lekë (të vjetër) ka përfutur me statistike në 15 vjet zotëria që fuste kartën në bankomat pa u skuqur fare. Nëse ndonjë nga miqtë më gjen diku në Europë, Amerikë, Australi ose në Hën apo në Mars një "grabitës" të tillë, ju lutem miq të më bëjë me dije. Ndërkohë individi "hani pini dhe rrëmbeni" është edhe një

Aktori Mirush Kabashi, gjatë një emisioni televiziv, nuk kurseu drejtorin e Teatrit Kombëtar. "Natyrisht që ka censurë. Ajo ka kaluar nga pushteti në teatër. Jemi më keq se në diktaturë. Problemi kryesor është ligji për teatrin", - tha Kabashi.

Opinion i Ditës

Milionerët politikë dhe të varfrit

Nga Rexhep QOSJA

(vllon nga faqja 1)

... Në mendjen time është krijuar pamja e dy lloj milionerëve të Kosovës së sotme: pamja e milionerit, të milionuar, domethënë të pasuruar, me djersë, me mund, me aftësi punuese e menaxhuese, në njërin anë, dhe pamja e milionerit të milionuar, të pasuruar turr, vrap, me punë politike, domethënë në sajë të pozitave politike, në të vërtetë duke shfrytëzuar e duke shpërdoruar pozitat politike e shtetërore!

Milionerët e llojit të dytë, të pasuruar në sajë të pozitave politike, janë temë çdo ditë e më e shpeshtë e bisedave, në të vërtetë ende më shpesh e pëshpëritjeve sesa e bisedave të hapëta të qytetarëve.

Dua të them disa fjalë për këtë milionerin tonë politik sjell-jeharlisur, të pasuruar në mënyrë tragjikomike, në sajë të posteve politike e shtetërore!

Po i dëgjoj çdo ditë milionerët politikë duke qarë e vajtuar hallet e të varfërve.

Vajet e këtyre "humanistëve", këtyre "shpirtmirëve" politikë për të varfrit sot janë më të shpeshta dhe më të zëshme se para një viti!

Nuk e kuptoj plotësisht arsyen e këtij "njerëzillëku" të tyre!

Në Kuvendin e Kosovës dhe në Qeverinë e Kosovës është shtuar numri i milionerëve politikë që qajnë hallet e të varfërve, kurse në Kosovë po shtohet çdo ditë e më shumë numri i të varfërve.


Në Kuvendin dhe në Qeverinë e Kosovës është shtuar numri i milionerëve politikë, që qajnë hallet e të varfërve, kurse në Kosovë është shtuar numri i të rinjve e të reja, që bëjnë çmos për të ikur prej atdheut të vet e për të gjetur shpëtim nga skamja në Evropë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Kanada, në Australi, në Zelandë të Re, në Turqi, në Japoni apo, madje, edhe në Korenë e Jugut.

Çfarë cinizmi tragjikomik përmban ai vajtim i milionerëve politikë e shtetërorë!

Milionerët tonë politikë, të pasuruar, krijuesit e fjalëve të reja do të mund të thoshin edhe të milionuar, në sajë të pozitave politike, që u janë dhuruar gjatë votimeve vendore a të përgjithshme, kur e kur edhe vendore dhe të përgjithshme, po i vajtojnë hallet e shtuara të të varfërve jo vetëm shpesh, jo vetëm me shumëllojshmëri, por edhe shumëllojshmëri: në mblidhje partiake, në mblidhje jopartiake, në takime e konferenca të ndryshme, në biseda me gazetarët e televizioneve e të gazetave, me vendorë e të huaj, e, sidomos, në kuvendet komunale dhe në Kuvendin e Kosovës, por numri i të varfërve po shtohet me gjithë sasinë e madhe të lotëve të milionerëve!

Çfarë ironie përmban kjo shumëllojshmëri tragjikomike lotësh!

Milionerët tanë politikë po



ua qajnë hallet jo vetëm të varfërve të rinj po edhe të varfërve të vjetër, kurse vaji i tyre për varfërinë e të vjetërve e të vjetrave është më i lot-paktë. E kuptueshme: e dinë se s'do të vajtojnë gjatë për varfërinë e tyre!

Milionerët tanë politikë kohëve të fundit po qajnë hallin jo vetëm të të varfërve të të gjitha moshave, po edhe të të varfërve të të gjitha gjinive – të gjinisë mashkullore e të gjinisë femërore.

Sa i gjithanshëm na është bërë "njerëzillëku" i milionerëve tanë politikë!

Milionerët tanë politikë po qajnë e vajtojnë hallet e të varfërve të të gjitha gjinive dhe të të gjitha moshave më së shpeshti duke qëruar hesape politike e partiake me kundërshtarët goftë kur janë në opozitë, goftë kur janë në pozitë! Dhe këta të opozitës na mësojnë se numri i të varfërve është shtuar, kurse vetë varfëria është thelluar prejse kjo, pozita, e ka marrë pushtetin, ndërsa këta të pozitës na mësojnë se numri i të varfërve është shtuar e varfëria në përgjithësi është thelluar në kohën kur kjo, opozita e tashme, ishte në pushtet!

Sa mirë e njohin, "historinë" e këtyre ditëve dhe sa shumë e duan të drejtën milionerët tanë politikë të pasuruar në mënyrë komike për ta, por gjithnjë tragjikomike për shtetin e Kosovës!

Milionerët tanë politikë, të milionuar në sajë të pozitave politike e shtetërore, që kishin dhe që vazhdojnë të kenë, po qajnë hallet e të varfërve të të gjitha gjinive e të të gjitha moshave, kurse, pa shikuar djathtas a majtas, po

punësojnë të vetët: familjarët e vet, shokët e vet, miqtë e vet, puthadorësit dhe puthakëmbësit e vet pa marrë parasysh sa e meritojnë atë punësim atë!

Çfarë "njerëzillëku" duçë-ist përmbajnë vajtimet e milionerëve tanë politikë për të varfrit!

Milionerët tanë politikë po e vajtojnë gjendjen e të varfërve të Kosovës, kurse pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të familjarëve, të të afërmeve dhe të miqve të tyre po shtohen gjithnjë e më shumë dhe po shtohen në sajë të posteve dhe marifeteve të milionerëve tanë politikë!

Sa demokratike është politika familjare dhe farefisnore e milionerëve tanë politikë!

Milionerët tanë politikë vazhdojnë të qajnë hallet e të varfërve tanë, numri i të cilëve sado vjen e shtohet, kurse privilegjet e ndryshme, të shumëllojshme e të gjithkohshme të milionerëve po ashtu po shtohen dhe po shtohen në përpjesëtim të drejtë me shtimin e numrit të të varfërve!

Sa shumë i duan të drejtat e punëtorëve dhe sa shumë e duan shtetin social këta milionerët tanë politikë e shtetërorë!

Milionerët tanë politikë po qajnë zëshëm, gjithnjë e më zëshëm, hallet e të varfërve tanë, kurse shkëlqesitë e tyre dhe lartmadhëritë e tyre janë gjithnjë e më të shkëlqesishme dhe më të lartmadhërishe jo vetëm në Kosovë, jo vetëm në Kosovë e në Shqipëri, jo vetëm në Kosovë e në Maqedoni, jo vetëm në Kosovë e në Luginë të Preshevës, jo vetëm në Kosovë e në Mal të Zi, por edhe në një varg shtetesh të Bashkimit Evropian dhe

në Shtetet e Bashkuara të Amerikës!

Sa tragjikomikisht përsh-typëbërës është ky vajtim i milionerëve tanë politikë për të varfrit!

Milionerët tanë politikë, të milionuar në sajë të pozitave politike, të cilat u janë dhuruar prej votuesve e ndonjëherë tanë për-vetësuar pa votime, po e qajnë hallin e të varfërve në njërin anë, kurse në anën tjetër po u shtohen punët e llojeve të ndryshme jo vetëm partiake, politike e shtetërore, por edhe arsimore, shkencore, turistike, me shkuarje e ardhje të shpeshta, kombëtare e ndërkombëtare, që u sjellin rroga, honorare, mëditje, çmime, përfitime ditore e gjatëkohore, që s'harrohen!

Sa tragjikomike, ironike, cinike, më shumë tragjike sesa komike, është demagogjia e milionerëve tanë politikë!

Deri kur të varfrit e Kosovës do të durojnë lotët e krokodilta të milionerëve politikë për gjendjen e tyre të mjeruar; deri kur do të durojnë lotët e krokodilta të milionerëve politikë, të cilët postet politike e shtetërore i kanë përdorur e shpërdorur e kriminalizuar për t'u bërë vrap me miliona, me toka të reja, me shtëpi e pal-late, me nga tri, katër, pesë bane-sa, me restorante, me pompa të benzinshe, me vila në bjeshkë e në bregdet, me lokale afariste, me vetura të shtrenjta, e me prona të tjera të ndryshme ende të paemërtuara! Nuk e di! Por, e di se shpejt, më shpejt se ç' e mendoja, po bëhemi shoqëri politike në të cilën asgjë nuk është e turpshme përpos që të jesh i varfër, i varfër, dhe për

shkak të varfërisë, i shpërfillur dhe i nënçmuar prej milionerëve politikë të pasuruar, të shumëmilionuar, në sajë të pozitave politike e shtetërore zhatëse!

E interesi i qytetarëve të Kosovës, i të gjithë shqiptarëve, kudo qofshin ata, është që Kosova sa më parë të bëhet shtet demokratik, pa autoritarizmin që e mundon shumë e veta komprometon lotët e rrejtshëm të milionerëve politikë për të varfrit, që merr masa ligjore ndaj të zhyturve në konflikt interesi, që merr masa ndaj abuzuesve të tenderëve. E të tjera.

Është interes i qytetarëve të Kosovës, i shqiptarëve kudo qofshin ata, që edhe Kosova, si vendet vërtet demokratike, të ketë Ligj për prejardhjen e pasurisë, në sajë të të cilat do të hulumtohet sidomos pasuria e funksionarëve të lartë shtetërorë, duke përfshirë këtu, natyrisht, edhe kryetarin dhe kryeministrin. Dhe, si shtet me korupsion pandemik, si e kanë theksuar sa e sa herë autoritetet e BE-së, të ketë edhe prokurorin e pavarur, i cili do të hulumtojë prejardhjen e asaj pasurie të funksionarëve të lartë, të "peshqve të mëdhenj" si i quajnë të varfrit dhe ndërkombëtarët oligarkë politikë të pasuruar, të milionuar, me poste të larta politike e shtetërore duke rrjepur Kosovën!

Është interes i qytetarëve të Kosovës, i shqiptarëve kudo qofshin ata, që Kosova të bëhet shtet demokratik e sovran, në të cilin nuk do të ketë poltronizim politik e shtetëror me pasoja kombëtare: shtet në të cilin nuk do t'u bëhet e mundshme atyre që po derdhen lotët të rrejtshëm për të varfrit sot, që me poltronizimin e dëshmuar në vazhdimësi, dhe duke flijuar interesa kombëtare, të përfitojnë përkrahje ndërkombëtare për të vazhduar karrierën e tyre pushtetore tragjikomike eksploatuese!

Deri atëherë intelektualët që kanë mendjen për mendim të pavarur do të duhej të jenë me të varfrit e të varfër, të varfër për të cilët nuk vajtojnë milionerët politikë!

Ashtu intelektualët do të varfëroheshin materialisht, por do të ngriteshin shpirtërisht dhe moralisht!

Dhe, këtë ngritje shpirtërore e morale do ta shquanin e do ta dëshmonin edhe më shumë po të shkruanin romane, drama, monodrama me personazhe milionerë politikë e të varfër, përmes të cilëve do të paraqiteshin gjithë kundërshtitë tragjikomike në Kosovë sot.

Edhe milionerët politikë edhe të varfrit e Kosovës e dinë, besoj, se romane, drama, monodrama e vepra të tjera mos sot nesër për ta do të shkruhen!

Prishtinë, 13.6.2018

Opinioni / Ditës

Brezi i ri i historianëve dhe nevoja për rikonceptimin e gazetarisë historike!

Nga Armand PLAKA *

(vijon nga faqja 1)

... të gjitha kanë pasur një problem: njëanësinë në trajtimin e çështjeve dhe daljen në përfundime që e shohin njëri-tjetrin si tepër kundërtë, duke e sjellë gjithë diskurin në një qerthull pa fund dilemash e pikëpyetjesh që shpesh na hutojnë tërësisht e në disa aspekte na bëjnë edhe qesharakë në sy të botës.

Nëse si më tipikën do të shihnim ndarjen që mbizotëron për çështjen e "Festës së çlirimit", do të mund të vijonim me një sërë çështjesh e tamatikash të tjera që paradoksalisht sa vijnë e zgjerohen.

Kështu, ndërsa debatojmë për Luftën (e Dytë Botërore), të vjen ndërmend se çfarë thuhet e shkruhet për mënyrën se si u zhvillua ajo në Shqipëri, për gabimet e përfitimet, për fajtorët e ngadhënjimitarët, për kolaboracionistët e çlirimtarët, për të (mbi) vlerësuarit e të harruarit e kështu me radhë.

Debat tashmë prej kohësh ka edhe për Skënderbeun, për origjinën e tij, për identitetin shqiptar, rolin e Esat Pashës, për ish-monarkun Ahmet Zog, për figura e profile të harruara nga balta e pluhuri, për ndërhyrjet politike të djeshme e kulturi e individit, për ish-viktimit e regjimit të shkuar, për islamizimin e shqiptarëve, pra në thelb për gjithçka.

E megjithatë, deri këtu nuk shoh asgjë të keqe, pasi debati në çdo rast i jep frytet e veta.

Ajo që më bëri të lëvizja për të shkruar këtë opinion, është një ngasje e kahershme që lidhet me një fenomen që megjithatë duket sikur shkon kundër rrymës, ose, le të themi më mirë, përtej rrymës, duke nxjerrë në pah kontribute që ia vlen të përmenden e vlerësohen.

Nëse do i referohemi aksionistëve popullore se "koha e mirë duket qysh në mëngjes", atëherë na duhet të besojmë se jemi në rrugë të mbarë.

ELITA TË REJA, KONTRIBUTET TË DUKSHME

Të barslarguar nga emocionet false, ngarkesat dhe ndikimet boshe të së shkuarës së afërt, ata përbëjnë elitën e re të historianëve shqiptarë. Dhe nuk janë pak: Dr. Marenglen Kasmi, Dr. Dritan Egro, Dr. Dorian Koçi, Dr. Ledia Dushku, Ilirjan Gjilka, Erald Kapri, Niko Kotherja, Dr. Arditi Bido, për të vijuar kështu - duke u kërkuar ndjesë - edhe më të tjerë që do të ishin plotësisht të denjë të vijonin këtë listë. Dikush histori-an profesionist, dikush në mënyrë të tërthortë, dikush në krye të një institucioni e dikush si studiues i pavarur; ajo që i bashkon janë pasionit dhe kontributet.

Ata janë tashmë ikona të një brezi që suksesin e bazon në punë dhe që më së shumti i largohen



tamtameve e gërgëreve të politikës së ditës, duke preferuar t'u besojnë tërësisht hulumtimeve e fakteve, përpara se të arrijnë në përfundime.

Në dukje pa asnjë idhull për të ndjekur, duket se ata janë sa të heshtur, aq edhe aktivë. Organizojnë ekspozita, simpoziume, nuk lodhen së nxjerri në pah vlera të harruara, artefakte nga thellësia e tokës e të bëjnë studime, të nxisin debate të guximshme e të mos i shmangen përplasjes edhe me "peshat e rënda", duke treguar se në këtë vend ka dhe do të ketë shpresë se gjerat ecin dhe duhet të ecin.

Nuk është thjesht këmbim elitash, por këmbim cilësor elitash, i domosdoshëm në stadin që po kalojmë, në një vend që paradoksalisht vijon të mbetet një urë kulturash e ndikimesh, prirjes e besimesh, ku historia fatqësisht ka qenë edhe njëra ndër nyjat kryesore ku politika ka futur hundët pa fund e frë duke e shfrytëzuar barbarisht.

NDRYSHIM NË MENTALITET

Sigurisht se të qenit i ri, u jep atyre edhe energjinë që ta dikton mosha, por më i rëndësishëm se komponenti fizik, është pikërisht mentaliteti i tyre, zelli dhe dëshira për punë, pasioni prej hulumtuesi dhe objektiviteti në trajtimin e çështjeve, duke zbuluar përtej tyre edhe aftësi e strategji të rralla menaxheriale në institucionet që (disa syresh) tashmë drejtojnë.

Mjafton të përmendim shtimin e dukshëm të aktiviteve brenda e jashtë sallave të Muzeut Historik Kombëtar, Arkivit të Shtetit, Qendrës (sot Akademisë) së Studimeve Albanologjike, por edhe të Muzeut të Arsimit, Muzeut të Artit Mesjeteran në Korçë, muzumeve në Krujë, Shkodër e gjetkë (duke mos e pëzier këtë me turizmin), dhe zgjerimit të hartës arkeologjike, digjitalizimit të shumë fondeve arkivore e çeljen e shumë ekspozitave, apo mbajtjen e simpoziumeve, si edhe prurjeve individuale e koleksioneve "atipike" që për-

bëjnë të gjitha risi më vete e ua sjellin kësaj sidomos shqiptarëve të brezit më të ri, historinë e vendit të tyre më pranë se kurrë në klasa e shkolla, në shtëpi e madje edhe në autobusë.

Ata s'kanë bërë as "Betimin e Hipokratit" e as duket se kanë premtuar atë që nuk mund të realizohet, por aktiviteti e statura e tyre e deritanishme vërteton përditë e më shumë se ata i janë betuar parimeve të tyre të profesionalizimit dhe i janë dhënë me shpirt përmbushjes së objektivave tejet pozitive, për të cilat duhet të jenë krenarë.

NEVOJA E NJË FRYME TË RE NË GAZETARINË HISTORIKE

Dukshëm duhet thënë se po kontribuojnë në këtë aspekt edhe një brez gazetarësh, të cilët në print apo në TV, po sjellin alternativa shumë pozitive e këndvështrime serioze në trajtimin e temave më të debatuar në kohës, duke avancuar tashmë një traditë të gazetarisë historike, e cila lindi me ndërrimin e sistemeve.

Larg skemave shabllone, tashmë ka ardhur koha që të mos mjaftojë më vetëm intervista me protagonistët, marrja e përcjellja e një materiali pa u konsultuar me burime alternative, goftë kjo në shqip apo gjuhë të huaj, e as të mbizotërojnë empirizmi, por shpirt i analitik, hulumtimi, vlerësimi dhe opinioni, duke synuar vërtetësinë, objektivitetin dhe paanësinë, në një gjykim të ftohtë e duke iu nënshtruar trendeve më të reja të trajtimit të historisë, duke i shërbyer kësaj vendit e kombit, me guxim, njohuri e këmbëngulje.

Është e vërtetë se për momentin është kthyer në një tendencë thuasje trajtimi i së shkuarës diktatoriale, e cila në një vend si Shqipëria do vinte koha të merrte vëmendjen e duhur, megjithëse kjo më shumë falë ndjeshmërisë së lartë që kanë organizatat e huaja, fondacionet dhe ambasadat, të

cilat duket se e kanë kuptuar më së miri vlerën e dokumentimit dhe evidentimit të vendeve e dëshmive më pikante të mbajtjes më këmbë të një diktature të llojit të veçantë, si ajo shqiptare dhe vuajtje e dramave që shkaktoi.

Në këtë kuadër janë për t'u përsëndetur një cikël dokumentarësh, apo dhe çelje e mirëmbajtje të vendeve të "kujtës kolektive", rreth të cilave, në fakt, kohët e fundit ka pasur nga ana tjetër një debat "agresiv".

Shpresojmë që të gjenden fondet e nevojshme e të krijohet mundësia të finançoen edhe projektet e ide që lidhen me etapa të tjera historike, në mënyrë që të rrëmohet më thellë, të zbulohen e dokumentohen kësajsoj edhe guva të tjera e pika të errëta të historisë sonë.

Tashmë ka ardhur koha që gazetaria historike të kanalizohet e të mos jetë vetëm një shtojcë fshehur nën logon e rubrikës "Dossier", e cila të lidh me aktualitetin ndonjëherë në mënyrë fare banale, si një skllave e përlurur e politikës së ditës, e që përmbajtjen e saj mund ta botosh shpesh pa e vrarë mendjen e pa parë datën, duke e trajtuar vetëm si një lopë, nga e cila mund të mjellesh një numër të madh klikimesh e lexuesish.

SHQIPTARËT, "DASHNORË" TË HISTORISË

Edhe pse gjuhë paksa e izoluar e me pak recipientë në krahasim me gjuhët e mëdha, lexuesi shqiptar, si një popull ndihmës, i prekur më shumë nga ndikimet e lëvizjet historike, duket se ka vlerësim për të tilla tema, e në mënyrë proporcionale kërkon kësajsoj të gjejë cilësinë, thellimin dhe risinë, e të mos bjerë prë e përsëritjeve të pavlera e shabllone, e një tautologjive lodhëse e të pafrytshme, ku synimi është shpesh scoop-i pa përmbajtje, titulli pa objekt e sasia pa cilësi.

*Autori është ish-bursant i Fondacionit "Konrad Adenauer" dhe i Bundestagut Gjerman në Berlin.

HOROSKOPI

DASHI

Hëna do të ndezë midis jush dhe partnerit zjarr të sedrës dhe xhelozisë. Thuajini po dialogut dhe arsyelimit për të zgjidhur problemet. Mos i mbronni miqtë edhe kur nuk kanë të drejtë. Jini më të ekuilibruar në justifikime.

DEMI

Marsi në qiellin tuaj është i gatshëm të dëgjojë zërin e Hënës. Do të pranoni mundësinë e një pune të papritur dhe shumë të dëshiruar. Me Uranin dhe Saturnin kundra mund të vini në pikëpyetje disa zgjedhje. Vazhdoni përpara!

BINJAKET

Me Plutonin kundra, nëse mbani inat ndaj dikujt apo diçkaje, do të jetë më e zgjuar dhe e frytshme të përbaleni me problemet dhe t'i tejkaloni. Bëni një zgjedhje të saktë me personat me të cilët rrini: jo të gjithë ju ndihmojnë të vlerësoni cilësitë tuaja.

GAFORJA

Me bashkëveprimin e Hënës me Merkurin do të nxiteni nga kureshtje të reja. Do të keni mundësinë të keni frymëzim për të shprehur idetë. Do t'i largoheni atyre që u japin më shumë rëndësi gjërave sipërfaqësore, duke zgjedhur pasurinë e karakterit.

LUANI

Me Hënë që ju favorizon, nëse jeni beqar, dikush do t'ju afrohet me ndjenja të singerta, po ngadhënjimi nuk do të jetë i lehtë. Do të pretendoni gjithmonë shumë. Në horizont shquhen mundësi të mira profesionale, që duhen shfrytëzuar menjëherë. Mos i lëni t'ju ikni.

VIRGJERESHA

Për shkak të veprimtarisë së Hënës, ritmet e ditës do të bëhen të paqëndrueshme. Do të jetoni momente kënaqësie, por edhe çaste pasigurie. Mos e shmangni afrimin e një personi që keni njohur së fundmi, mund t'ju bëjë kureshtarë më shumë sesa mendoni.

PESHORJA

Për meritë të Marsit dhe Uranit që i bujqësohin Hënës, sot marrëdhëniet tuaja do të jenë më të fuqishme. Mund të ndryshoni mendje për një eveniment. Do të keni takime të rrekuellueshme që do t'ju ndryshojnë jetën e dashurisë apo do të forcojnë lidhjet ekzistuese.

AKREPI

Kundershtimi i Uranit i bën disa vendime të vështira. Prandaj, nuk ju ngelet gjë tjetër, përveçse të angazhoheni! Tregohuni të vëmendshëm ndaj kritikave të një miku, për të kuptuar se çfarë përshpirtjesh kanë të tjerët për ju.

SHIGJETARI

Për ta pasur të qetë jetën në çift, është e udhës që t'i përshatëni kërkesave të ndryshme të partnerit dhe të jetës. Dorëzohuni përpara fakteve. Me Neptunin dashmirisë, përkuftojuni një kauze të rëndësishme. Jini të gatshëm t'ju jeni atyre që nuk kanë.

BRICJAPI

Nëse jeni në kërkim të një pune, me Jupiterin që ju ndihmon, bëni gjithçka mundni për të goditur në shenjë. Do t'ia dilni, padyshim! Jini më altruistë. Jepini prova të bujarisë suaj, duke ndihmuar ata që kanë më nevojë për ju.

UJORI

Për meritë të Neptunit në qiellin tuaj, do të dini si të dilni nga situatat e përditshme falë një intuete të pagabueshme. Do t'ju propozojnë t'ju përkuftoheni personave në nevojë apo të bëni bamirësi.

PESHQIT

Marsi dhe Venusi do të bëhen bashkë për të bërë që të kaloni kohën në shoqëri të mirë. Do të merrni më të mirën e asaj që ju rethron. Nëse duhet të dilni të flisni para njerëzve, do të jeni shumë të favorizuar nga një shprehje e qartë dhe e saktë.

FLET SULMUESI



Plaku: Te Kukësi erdha për Champions League

Një merkato që meriton një notë maksimale, kjo e deritanishmja për skuadrën e Kukësit, që nuk di të ndalet sa u përket afrimeve në skuadër. Padyshim që një goditje e madhe mund të quhet edhe ajo e Sebino Plakut, pasi futbollisti që iu bashkua së fundmi verilindorëve, kaloi një sezon fantastik me

Kamzën. Por kur flitet për arsyen kryesore se përse Plaku iu bashkua Kukësit, futbollisti nuk preferon të fshihet, duke thënë se ka ardhur për të luajtur në "Champions League". "Kam ardhur sepse Kukësi luan në "Champions League". Më pas ishte një insistim i Nexhpit dhe çdo futbollist ëndërron të luajë në

arenën europiane. Të gjithë lojtarët janë të kalueshëm dhe për mua është një mundësi e re, do të mundohem të jap më të mirën. Klubi ka objektiva të qarta dhe shpreson që të ketë fat në short, për të kaluar ekipin e parë. Nëse kjo ndodh, atëherë mund të realizohet objektivi. Drejtuesit kanë treguar besim që unë të jem këtu për Europën. Nëse gjërat shkojnë mirë, atëherë ne do të vazhdojmë edhe në të ardhmen", ka thënë Plaku.

Kukësi ka në dorë një mbrojtës që kushton 600 mijë euro

Kukësi duket se është i pandalshëm në këtë merkato vere, ku deri tani ka arritur të afrojë në skuadër shumë elemente të rinj, të cilët mund të jenë të vlefshëm për sezonin që po vjen. Së fundmi, verilindorët duket se kanë bërë një goditje të bujshme në këtë merkato. Sipas "Supersport", Kukësi ka arritur akordin me mbrojtësin brazilian Uilliam Kordeiro Melo, që vjen nga skuadra e Oestes, nga kampionati brazilian, ndërkohë që më parë ka qenë edhe pjesë e Figuresens. Kartoni i mbrojtësit Melo, arrin vlerën e 600 mijë eurove dhe padyshim që kjo është një shifër rekord për kampionatin shqiptar, pasi arrin në vlerë thuajse të njëjtë me Gurin dhe Abazajn që u larguan gjatë këtij viti, duke menduar, se roli i Melos është mbrojtës dhe jo sulmues.

Largimi i Lopeteguit solli kaos në ekip. Lojtarët tentuan të kthenin vendimin për shkarkimin

Hierro: Spanjollët të kenë besim, do bëjmë një Botëror të madh

Trajneri i ri në detyrë, vetëm për Kupën e Botës

Jeton Selimi



Kemi ardhur në Rusi për të zhvilluar një Botëror të madh dhe objektivi nuk ndryshon pavarësisht gjithçkaje", ishin këto fjalët e para të Fernando Hierros, ish-mbrojtësit legjendar të Realit të Madridit si trajneri i ri i Spanjës. Hierro i ka idetë e qarta dhe në konferencën e parë për shtyp si numri 1 i stollit të La Rojas përcjell siguri, eksperiencë dhe gjallëri. 50-vjeçari nuk ka pasur asnjë dyshim kur është thërritur në detyrë nga presidenti i federatës spanjolle, Rubiales duke mos u menduar 2 herë. "Bëhet fjalë për një mundësi unike, të cilën e pranoj me forcë dhe dëshirë. Spanjollëve u them të kenë besim, sepse grupi i futbollistëve është shumë cilësor dhe i ka idetë të qarta. A do të ketë ndryshime në formacion? Asnjë sepse nuk ka kohë dhe mbi të gjitha në këto 2 vite është punuar shumë mirë. Nuk ka asgjë për të korrigjuar". Hierro u emërua trajner vetëm për Botërorin dhe për momentin ai nuk mendon aspak për të ardhmen pasi dëshiron t'i gëzojë të tashmes. "Unë jam i përqendruar vetëm tek Portugalia, më pas vë-



mendja ime do të shkojë tek Irani dhe Maroku. Nuk është momenti për të menduar për gjëra të tjera, nëse do të jem trajneri i Spanjës edhe para Botërorit apo jo. Kam qenë trajner pas kam bërë sërish rolin e drejtorit sportiv dhe tashmë jam sërish trajner. Në qendër të të gjitha gjithësi është topi i futbollit". Këtë të enjte Hierros do t'i bashkohen dy persona që kanë qenë bashkëpunëtorë të tij tek skuadra e Real Oviedos, pasi dy nga bashkëpunëtorët e Lopeteguit

janë larguar së bashku me ish-trajnerin drejt Madridit për ta ndjekur atë në aventurën e tij të re në krye të "Los Blancos". **KAOSI**
Përfaqësuesja spanjolle është përfshirë nga kaosi vetëm një ditë para fillimit të "Rusi 2018" me përplasje të ndezura mes drejtuesve të Federatës dhe lojtarëve rreth shkarkimit të Julen Lopeteguit. Drejtuesit e Federatës kishin vendosur të shkarkonin trajnerin, duke cilësuar një fyerje të rëndë

faktin se ai kishte pranuar ofertën e Real Madridit dhe kishte zyrtarizuar atë 2 ditë para Botërorit. Për këtë arsye u njoftua se do të kishte një konferencë për shtyp në orën 10:30. Por sapo lojtarët mësuar për këtë vendim, iu kundërvënë drejtuesve. Kësaj konferencë u shty për më shumë se një orë, ndërsa lojtarët zhvilluan mbledhje me drejtuesit e Federatës rreth këtij vendimi. Të udhëhequr nga kapiteni Ramos, i cili do ta ketë si trajner Lopeteguin edhe te Real

Madrid pas Botërorit, spanjollët kanë kërkuar të bindin drejtuesit e Federatës që të mbajnë trajnerin në drejtim, pasi do të ishte një dëm i madh për ekipin largimi i tij i parakohshëm. Por drejtuesit e Federatës e cilësuan të papërshtatshme mënyrën se si kishin rrjedhur ngjarjet. "Jemi në një situatë të komplikuar, shumë të komplikuar. Vlerësoj shumë Lopeteguin, por ka mënyra të duhura se si të bëhen gjërat. Janë lajmëruar me një telefonatë nga ai vetëm 5 minuta para se Realit të lëshonte deklaratën për shtyp. Ky ekip vazhdon punën pavarësisht trajnerit", ishin fjalët e presidentit Rubiales në konferencë. Vendimi i tillë kundër dëshirës së lojtarëve komplikon gjithçka, pasi shumë prej pjesëtarëve të stafit të Lopeteguit mund të largohen bashkë me të drejt Realit, ndërsa nuk dihet ende se kush do të jetë në pankinë për duelin e parë kundër Portugalisë e kush do të marrë vendimet teknike.

SERIA A




Tashmë edhe një derbi mes vëllezërve Simone dhe Filippo Inzaghi

Këtë sezon, përveç ndeshjeve "derbi" të qyteteve, do të kemi edhe një ndeshje të veçantë, pasi dy vëllezërit Inzaghi do të konkurrojnë ndaj njëri-tjetrit në Itali. Filippo Inzaghi është emëruar zyrtarisht si trajner i Bolonjas, duke u rikthyer sërish si trajner në Serinë A, pas një aventure 2-vjeçare me skuadrën e Venecias. Ai do të ketë një derbi pikërisht me vëllain e tij, Simone Inzaghi i cili drejton Lacion e Strakoshës, ku me shumë siguri, Simone do të arrijë të triumfojë ndaj Filipos, duke qenë se Lacio ka më tepër kualitet se Bolonja. Në të kaluarën e tij, Filippo Inzaghi ka drejtuar edhe kuqezinjtë e Milanit, ku kalonte nga Primavera në skuadrën e parë, por pa arritur që të lërë gjurmë me skuadrën ku ka shkëlqyer si futbollist.

ARRESTIMET

Stadiumi i ri i Romës, 9 persona në pranga për korrupsion

Duke parë korrupsionin e kryer në fusha të ndryshme të jetës në Shqipëri, shpeshherë keqkuptohet fakti se devijime të tilla janë një "pjellë" vetëm e shtetit tonë. Sipas asaj që publikon "ANSA", policia italiane ka arrestuar 9



persona për projektin e ri të stadiumit në Romë. Kështu


pas shumë vëzhgimesh, është piketuar një shoqatë kriminale, e cila ka kryer një seri krimesh ndaj administratës publike lidhur me ndërtimin e stadiumit të ri në Romë. Një shembull i tillë na tregon më së miri se korrupsioni një "sëmundje", e cila prek edhe vende të tjera europiane, por ndryshimi me ne qëndron në faktin se këtu harrohen në mënyrë të qëllimshme masat ndëshkimore.

SHKARKIMI I LOPETEGUIT

Lëv habitet: Ishte e pazakontë, Spanja do ketë pasoja

Lajmi se Lopetegui u shkarkua nga Federata Spanjolle e Futbollit, vetëm një ditë para fillimit të Botërorit, ka shokuar edhe trajnerin e Gjermanisë, Joakim Lëv. "Unë nuk e di se çfarë ndodh pas skenave të federatës spanjolle, por kjo është diçka e pazakontë. Ishte një surprizë e madhe, pasi erdhi nga hiçi. Sigurisht që do të ketë pasoja për ekipin e Spanjës. Gjithsesi, ata kanë një filozofi të qartë për lojën, pasi lojtarët kanë vite së bashku", - deklaroi Lëv.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

2. Gjëja e latinëve.
5. Ai i Kuq u hap për hebrejtë.
9. Eshhtë fjala e për e foshnjës.
11. Ministri Ekonomie e Pune
13. Marubi i fotografisë.
14. Bel i Mapupassant.
15. Bëhet duke tregtuar objekte të shenjtja.
18. Derek aktore.
19. Gjysmë totale.
20. Eshhtë art i të folurit
22. Një patriark biblik.
24. Mund të jenë zemërkau të tilla.
26. Janë dëshmorë të kishës.
28. Eshhtë lloj papagalli.
29. Eshhtë lloj papagalli.
30. Qerre pa qe.
32. Ekstre me numërim.

33. Eshhtë bodrumi.
34. Steiger aktor.
35. Inicialet e Delon.
37. Eshhtë edhe ai Me Gropa.
38. Një mund të jetë autonom.
40. Në krye të evidencës.
42. Edgar Allan Poe.
44. Ekstremet në litar.
46. Giorgio i modës.
50. Janë malet me Akonkagua.
52. Janë ujërat e bregdetit tonë.

VERTIKAL

1. Novarro që qe aktor.
3. Kusturica regjisor.
4. Eshhtë e jashtëzakonshme.
6. Inicialet e Kazan.
7. Ishite qyteti i 100 portave.
8. Pinci i Dy herë mat.
9. Janë të mirat që prodhohen.
10. Eshhtë ai që gënjën për t'u bërë i njohur.

11. Një markë celulari.
12. Ushtrohej nga filibustierët.
16. Një përsiatje.
17. Agjenci Informative Tiranë.
21. Një brejtës pylli.
23. Një Gjon që qe aktor i yni.
25. Titulli i Byron.
27. Në radhë të parë.
31. Emri i Amundsen.
36. Moore aktore.
39. Pishtarë pa pishë.
41. Gjysmë vatani.
43. Rruga e Molnar.
45. Një fazë gjumi.
47. Inicialet e Redford.
48. Në krye të notarëve.
49. Inicialet e Reitman.
51. Unë dhe ti.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Nuk kalohet nga mbetësi.
5. U printe gladiatorëve
12. Bëhet duke shkuar lart e më lart
14. Tatum që qe pianist.
15. Një që lufton për para
16. Mund të bëhet me safari
17. Breshkat luftarake të kartonave
19. Ngjitet kur nuk nget
20. Në mes të rrugës
21. Sporti me rikisha
25. U shkrua nga Hesiodi
26. Një sferë për model
27. Mbyllin një sirtar
28. Makina Tipò
30. Inicialet e Bean, aktor
31. Nino, kompozitor i famshëm italian
33. Ramiro pa zë.

VERTIKAL


34. Neill i Jurassic park.
35. E bukura e belle époque.
37. Qe mbreti i elfëve
39. Farrow, aktore
40. Hagen rockstar
41. Walter i Kush do ta vrasë Charley Verrik
45. Në fund majtas
46. Mund të preken nga morbusi i Basedow
47. Ad... për të ngarkuarin me punë
48. Loach regjisor
7. Kompozoi Mefistofele
8. Në radhë të parë.
9. Qytet zviceran
10. Në krye të kryesisë
11. Ughi violinist
13. Carlos që qe pilot i Formula 1
15. Ekstre me muzg
18. Inicialet e Steinbeck
22. Gruda, "Njeriu me top"
23. Eshhtë X ajo e sulmit
24. Paradhoma e parajasës
28. Eshhtë edhe ai i luftës
29. Janë edhe ato të cirkut
31. Mbarojnë fare
32. Inicialet e Reed, aktor
34. Të parët në sondazh
36. Eshhtë taksa
38. Një mund të jetë emërоре
39. Një pjesë e marrëzisë
41. Gjysmë mirmoze
42. Hundë kur s'jam unë
43. Skuadër greke
44. Lempër, këngëtar gjermane
46. Fundi i një akti



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

4				1	
9	5			1	3 6
7	2		8		
1		7	2	5	
	3				9
		3		7	
4				1	
				9	8
1	2	5	8		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	4	9	3	7	1	8	5	2
1	5	7	8	9	2	4	3	6
8	2	3	4	5	6	7	9	1
4	3	2	6	1	5	9	7	8
5	6	8	7	3	9	1	2	4
9	7	1	2	4	8	5	6	3
7	8	4	9	2	3	6	1	5
2	1	6	5	8	7	3	4	9
3	9	5	1	6	4	2	8	7

Argëtim filozofik

- Ngjitu në majë për të parë botën. Jo për t'u parë bota.

- Dje isha i zgjuar dhe desha të ndryshoja botën. Sot jam i mençur dhe kam ndryshuar veten.

- "Duke bërë një njeri të buzëqeshi, ndryshon botën. Ndoshja jo gjithë botën, por botën e tij. Fillu me hapa të vegjël. Fillu tani"

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

17	1	8	4	2	4		13	1		13	1
18	3	1	4		18		3		17	13	1
8	1	10		10		10	1	3	1	6	12
3		1	10	2	3	6	14	1	12	2	4
	13	3	5	4	2	8	4	1	12	4	2
15	9	6	15	1	12	4	6		6	3	3
17	2	4	5	12		2	14		17	5	1
	8	1	7	6		3	1	10	1		2
15	5	12			4	6	4	18	7	7	1
1	3	2	8		1	5			2	12	2
20	19		1	3		20	5	4	6	10	2
6	1		10	2	3	2	12	15	18	2	8

M	I	K	E		K	M		S		E
E	K	A			R	O	M	A	K	E
K	M	I	L	I	T	A	N	T	E	T
M	A	T	E	M	A	T	I	K	A	
P	A	S	A	N	I	K		T		S
E	K	Û		A	N	E	T	A	R	E
R	E	T	E		E	I	R	A	N	I
I	T	R		B	L	A	K	E		L
M	I	A		R	E	D		E	K	I
E				M	E	T	A	L	E	I
T	E	K	E		M	K	U	M	T	
M	O	R	A	V	I	A		M	A	E

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	R	K	A	A	S	T	R	O	A	M	A
D	I	A	N	A	H	E	A	N	T	I	K
A	T	L	A	N	T	I	K	E	O	L	E
P	E	I	T	A	R	I	F	A	T	L	E
T	T	P	O	L	I	T	I	K	A	N	E
K	E	N	E	T	A	O	R	A	R	E	T
P	A	U	L	I	N	R	R	I			
A	K	E	O	T	A	D	D	I	M		
R	U	M	U	N	E	K	I	E	R	A	
E	T	J	I	T	E	R	I	A	M	A	N
T	E	I		G	O	R	D	I	A	N	E
I	N	T		A	R	G	M	A		T	I
P	A	R	M	E	L	E	R	G	O		
R	K	U	P	A	E	M	I	R	A	T	E
O	H	A	R	A	D	A	R	O	M	A	T
C	I	K	L	I	S	T	E	T			
S	T	A	D	I	U	M	E	T	A	P	E
D	I	K	A	S	T	E	R	E			
K	E	N	T		N	G	O	P	J	E	V
K	A	T	I	A	S	I	E	S	E		
A	R		N	I	O	L	A	I	R		
M	A	S	S	I	M	O	Z	A	N	O	R
A	M	A	N		A	N	N				
T	T	E	R	R	E	N	I	E	T	N	E

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Thënie të mençura

- Një idiot mund të bëjë më shumë pyetje
- në një minutë se sa dhjetë burra të mençur mund të përgjigjen në një orë.
- Një njeri i mençur mëson shumë nga një budalla, dhe një budalla nuk mëson
- asgjë nga një i mençur.
- - Të pamartuarit dinë më shumë për gratë se sa të martuarit. Nëse nuk dinin, do të ishin dhe ata të martuar.

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

